

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM



**Raport tremujor
nëntor 2024**



Përmbajtja

I. Lëvizjet makroekonomike	6
1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar	6
1.2. Oferta e brendshme	10
1.3. Kërkesa e përgjithshme	15
1.3.1. Konsumi personal.....	16
1.3.2. Konsumi publik	17
1.3.3. Konsumi për investime	17
1.3.4. Kërkesa neto për eksport.....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
1.4. Punësimi dhe pagat	19
1.5. Inflacioni	22
1.5.1. Inflacioni aktual	22
1.5.2. Pritshmëritë për inflacionin	26
1.6. Bilanci i pagesave	28
1.6.1. Llogaria rrjedhëse	28
Shtojca 1: Shkëmbimi në tregtinë e jashtme të mallrave dhe lëvizja e kursit nominal dhe real efektiv të këmbimit (NEDC dhe REDC)	29
1.6.2. Llogaria financiare.....	33
1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm bruto	34
II. Politika monetare.....	37
2.1. Likuiditeti i bankave.....	40
III. Lëvizjet në tregjet financiare	42
3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasiguruara	42
3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë	43
3.3. Bursat.....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
IV. Agregate monetare dhe kreditore	47
4.1. Agregate monetare	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
4.2. Aktiviteti kreditues	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
V. Financat publike.....	53
VI. Projektionet makroekonomike dhe rreziqet	56
6.1 Supozimet në projektionin e mjedisit të jashtëm	57
6.2 Projektioni dhe efekte mbi politikën monetare	60
6.3 Krahasimi me projektionin e mëparshëm	65



Hyrje

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, **në kushtet e ngadalësimit të konsiderueshëm të dinamikës së inflacionit të brendshëm, të tregut të favorshëm valutor, por me rreziqe ende të pranishme, Banka Popullore filloi me normalizimin e kujdesshëm të politikës monetare.** Në shtator, norma bazë e interesit u ul me 0.25 p.p., deri në nivelin 6.05%, dhe vazhdimësia e lëvizjeve të favorshme hapi hapësirë për ulje të mëtejshme me 0.25 p.p. Gjatë kësaj periudhe, normat e interesit për depozitat e disponueshme njëditore dhe shtatë ditore kanë mbetur të pandryshuara në nivel përkatësisht 4.20% dhe 4.25%. Për sa i përket politikës makroprudenciale, në fund të shtatorit u mor vendimi për ta zgjatur aplikimin e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit prej 1.75% edhe në tremujorin e katërt të vitit 2025. Ky pozicionim i politikave është në drejtim të mbështetjes së stabilitetit të përgjithshëm makrofinanciar të ekonomisë. Ndryshimet në politikën e brendshme monetare u ndikuan edhe nga pozicionimi i Bankës Qendrore Evropiane, e cila vazhdoi t'i ulë normat e interesit edhe gjatë tremujorit të tretë, gjatë vlerësimit për aktivitet ekonomik real më të dobët në Eurozonë se sa pritej dhe ngadalësimit të inflacionit të përgjithshëm në përputhje me pritshmëritë dhe nën presione më të moderuara nga kostot e punës dhe marzhat e fitimit. Pozicionimi i politikës monetare të BQE-së mbetet në zonën kufizuese.

Rreziqet kryesore për skenarin makroekonomik aktual janë të ngjashme me ato të parashikimeve të prillit. Megjithatë, rreziqet në rënie për rritjen nga mjedisi i jashtëm theksohen më tej dhe shoqërohen me përshkallëzimin e konflikteve rajonale, me rrezikun që politika monetare të qëndrojë e shtrënguar për një kohë të gjatë, me mundësinë e rinovimit të ndryshueshmërisë së tregjeve financiare, gjë që do të ndikonte negativisht në tregjet e instrumenteve të borxhit të qeverisë, më tej, me rrezikun e ngadalësimit më të madh të rritjes së ekonomisë kineze, si dhe me forcimin e vazhdueshëm të politikave proteksioniste, të cilat mund t'i intensifikojnë tensionet tregtare, ta ulin efikasitetin e tregut dhe t'i prishin më tej zinxhirët globalë të furnizimit. **Nga aspekti i rreziqeve të brendshme,** edhe në këtë cikël projeksionesh, në afat të shkurtër, ato lidhen me dinamikën e realizimit të projekteve të mëdha infrastrukturore. **Në afat të mesëm,** janë të mundshme efekte pozitive nga anëtarësimi në NATO dhe progresi në anëtarësimin në BE, si dhe nga Plani i ri i Bashkimit Evropian për rritje të Ballkanit Perëndimor, të cilat mund ta forcojnë integrimin ekonomik dhe konvergjencën socio-ekonomike të vendit, si dhe nga përdorimi i mundshëm i pozicionimit gjeografik të ekonomisë sonë në kuadër të procesit të nisur të përshtatjes së zinxhirëve globalë. **Në të njëjtën kohë, edhe anëtarësimi i pritshëm në Zonën e vetme të pagesave në euro (SEPA) do ta mbështeste integrimin e tregut të vendit, duke i hequr barrierat ndaj flukseve financiare me vendet anëtare të BE-së,** si pjesë e përpjekjeve për të transformuar infrastrukturën e pagesave dhe duke hedhur themelet në sferën financiare në rrugën drejt BE-së. Anëtarësimi në SEPA do të nënkuptonte një sistem pagese më të lirë, më të shpejtë dhe më efikas që në fund të fundit duhet të kontribuojë për konkurrencë më të madhe të sektorit të brendshëm korporativ.

Nga aspekti i treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, të rëndësishëm për ekonominë maqedonase, është ruajtur vlerësimi për rritjen e kërkesës së huaj efektive për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 është bërë një korrigjim minimal në rënie në raport me perceptimin e prillit. Për sa i përket **inflacionit të jashtëm efektiv,** është bërë një rishikim i vogël në rënie për vitin 2024, kurse projeksioni për vitin 2025 është mbajtur në nivelin e muajit prill. Rishikimet të **çmimit botëror të produkteve primare** janë kryesisht në rënie, ku edhe më tej pritet kryesisht një rënie e çmimeve në vitin 2024 dhe rritje e tyre në vitin 2025. Megjithatë, çmimet e produkteve primare vazhdojnë të shënojnë ndryshueshmëri jashtëzakonisht të lartë, gjë që krahas bazave, e reflekton edhe pasigurinë e lartë gjeopolitike dhe ekonomike. Përshkallëzimi eventual i goditjeve gjeopolitike mund ta komplikojë procesin e deflacionit që ka nisur, me pasoja negative edhe në aktivitetin ekonomik botëror.

Projeksionet e fundit makroekonomike për periudhën 2024 - 2027 tregojnë për një rritje pak më të dobët të ekonomisë maqedonase për këtë vit dhe vitin e ardhshëm, krahasuar me perceptimet e prillit, kurse në afat të mesëm, vlerësimet për rritje mbeten të pandryshuara. Kështu, në vitin 2024 pritet rritje prej 2.3%, që paraqet një rishikim në rënie krahasuar me vlerësimin e prillit për rritje prej 2.6%, me një gjysmë të parë të vitit pak më të dobët.



Rritja më e dobët e pritshme për vitin 2024, së bashku me vlerësimet për rimëkëmbje pak më të ngadaltë të kërkesës së huaj, çuan në **rishikim të lehtë në rënie të projeksionit për rritje në vitin 2025**, nga 3.6% në **3.3%**. Në këtë cikël projeksionesh, ruhet vlerësimi për rritje prej rreth 4% në vitin 2026. E parë në mënyrë strukturore, rritja ekonomike në periudhën 2024 - 2026 do të rezultojë nga kërkesa e brendshme, me kontribut negativ të eksporteve neto. Në kuadër të kërkesës së brendshme, pritet që **investimet bruto dhe konsumi personal të jenë nxitësit kryesorë të rritjes**, të mbështetur nga investimet publike dhe private, nga rritja e të ardhurave të disponueshme të popullsisë dhe nga aktiviteti kreditues i bankave. Në përputhje me arritjet më të larta dhe strategjinë e re fiskale, e cila parashikon konsolidim fiskal më të ngadaltë, në këtë cikël projeksionesh, **kontributi i konsumit publik vlerësohet pozitiv në periudhën e projeksioneve. Pas vlerësimeve për rënie në vitin 2024, në periudhën e ardhshme pritet rimëkëmbje e eksporteve**, në kushtet e një ambienti të jashtëm më të favorshëm, i cili, bashkë me rritjen e kërkesës së brendshme, do të pasqyrohet edhe në rritjen e importit. Kështu, pritet **kontribut negativ i eksporteve neto në rritjen e përgjithshme ekonomike. Rritja e ekonomisë vendase pritet të vazhdojë edhe në vitin 2027 me një dinamikë të ngjashme prej rreth 4%**, në një mjedis më të sigurt dhe prirje më të madhe për konsum dhe investime. Rreziqet ndaj rritjes janë ende të theksuara dhe kryesisht në rënie.

Inflacioni do të vazhdojë të ngadalësohet deri në fund të periudhës së projeksioneve. Vlerësimet më të fundit e konfirmojnë perceptimin e prillit për normë mesatare inflacioni prej 3.5% në vitin 2024. Për vitin e ardhshëm, pritet normë inflacioni prej 2.5% për vitin 2025, që përfaqëson një rishikim të vogël në rritje në raport me muajin prill, gjatë vlerësimit për inerci më të madhe tek një pjesë e kategorive të çmimeve. **Në një periudhë afatmesme, në periudhën 2026 - 2027, inflacioni pritet të ulet në mesataren historike prej 2%**. Rreziqet për projeksionin e inflacionit janë ende të lidhura me pasigurinë në lidhje me lëvizjet e ardhshme të çmimeve të energjisë dhe ushqimeve në bursat botërore për shkak të tensioneve dhe shqetësimeve aktuale gjeopolitike që lidhen me ndryshimet klimatike, si dhe me efektet e politikave që ndikojnë në kërkesën totale në ekonominë e brendshme.

Vlerësimet e fundit në segmentin monetar tregojnë për një rritje paksa më të fuqishme të aktivitetit kreditor të sektorit bankar në të gjithë periudhën e projeksionit, krahasuar me muajin prill. Sipas arritjeve pak më të larta që nga fillimi i vitit, për të gjithë vitin 2024 pritet një normë e rritjes së kredisë prej 7.5% (6.1% sipas projeksionit të prillit). Rritja pritet të vazhdojë në periudhën afatmesme, me dinamikë pak më të moderuar dhe me normë mesatare rritjeje prej 7.2% për periudhën 2025 - 2027, në kushtet e një pozicioni të qëndrueshëm të kapitalit dhe likuiditetit të bankave dhe në përputhje me pritjet për lehtësim gradual të kushteve financiare, përsheptim të rritjes ekonomike dhe stabilizim të pritshmërive të subjekteve ekonomike. *Rritja e kreditimit, si më parë, do të mbështetet nga rritja e depozitave, si burimi kryesor i financimit.* Depozitat në sektorin bankar pritet të kenë ritme të qëndrueshme të rritjes gjatë gjithë periudhës së projeksionit, duke pasur parasysh kushtet ende relativisht stimuluese për kursim në banka, besimin në sektorin bankar, si dhe rritjen e pritshme të të ardhurave të disponueshme të popullsisë. Në fund të vitit 2024, pritet rritje vjetore e totalit të depozitave prej 7.9% (7.4% sipas projeksionit të prillit). Për periudhën e ardhshme parashikohet rritje e qëndrueshme e mëtejshme e depozitave, e cila do të arrijë mesatarisht 7.7% në periudhën 2025-2027.

Në projeksionin aktual, janë ruajtur pritjet për pozicion të jashtëm të favorshëm dhe përgjithësisht të qëndrueshëm të ekonomisë në periudhë afatmesme, pa ndryshime në dukshme në raport me ciklin e prillit. Për vitin 2024 ende parashikohet një farë përkeqësimi në llogarinë rrjedhëse, pra pas suficitit të arritur një vit më parë, për këtë vit pritet deficit i moderuar prej 2.1% i PBB-së. Kjo dinamikë e projektuar vjen si pasojë e suficitit më të ulët të pritshëm të të ardhurave dytësore, në përputhje me pritshmëritë për stabilizimin e flukseve hyrëse neto në transfertat private pas arritjeve historikisht të larta në vitin 2023. Veç kësaj, deficitit tregtar pritet të zgjerohet në bazë vjetore, i nxitur nga komponenti jo energjetik, i cili do të kompensohet pothuajse tërësisht nga përmirësimi i suficitit të shërbimeve. Për periudhën e mbetur të projeksionit, 2025-2027, parashikohet mesatarisht deficit i llogarisë rrjedhëse prej 2.2% të PBB-së. Gjegjësisht, forcimi i eksportit, në kushtet e pritjeve të favorshme për çmimet e lëndëve djegëse, pritet të ndikojë në ngushtimin gradual të bilancit tregtar. Por, nga ana tjetër priten flukse dalëse që lidhen me korridoret 8 dhe 10-d, të cilat do ta rrisin importin e shërbimeve, si dhe reduktimin gradual të hyrjeve neto tek të ardhurat dytësore. **Gjatë gjithë periudhës së projeksionit priten flukse të qëndrueshme hyrëse neto në llogarinë**



financiare, të cilat do ta mbulojnë plotësisht deficitin në llogarinë rrjedhëse, me çka rezervat valutore do të vazhdojnë të rriten dhe do të mbahen në nivelin e duhur. Pjesa më e madhe e hyrjeve financiare mbi bazën neto priten në formën e investimeve të drejtpërdrejta të huaja dhe huamarrjes afatgjatë të shtetit.

Në përgjithësi, tabloja makroekonomike për sa i përket ecurisë së rritjes ekonomike, ngadalësimit të inflacionit dhe pozicionit të jashtëm të ekonomisë së brendshme për të gjithë periudhën e projeksionit nuk ka ndryshuar ndjeshëm në krahasim me ciklin e projeksioneve të prillit. Rritja ekonomike pritet të vazhdojë të ndjekë një ecuri në ngjitje në periudhën e projeksioneve, pak më të moderuar në periudhën afatshkurtër, ndërkohë që inflacioni do të vazhdojë të ngadalësohet dhe në periudhë afatmesme do të reduktohet në mesataren historike. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë vijon të vlerësohet si i favorshëm, me deficit të moderuar në llogarinë rrjedhëse në periudhën afatmesme dhe me hyrje të qëndrueshme financiare, të cilat për rrjedhojë do ta mundësojnë rritjen e rezervave valutore gjatë periudhës së projeksioneve dhe ruajtjen e tyre në nivelin e duhur. **Rreziqet për skenarin bazë makroekonomik mbeten, si nga mjedisi i jashtëm ashtu edhe nga ai i brendshëm, dhe janë kryesisht të ngjashme me projeksionet e prillit.** *Është i nevojshëm monitorim i mëtejshëm dhe kujdes më i madh për politikat që ndikojnë mbi kërkesën në ekonominë vendase.* Banka Popullore i ndjek me kujdes të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe, si më parë, do t'i marrë të gjitha masat e nevojshme dhe do t'i përdorë të gjitha instrumentet që i ka në dispozicion, për ta ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe stabilitetin e çmimeve.



I. Lëvizjet makroekonomike¹

1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar


Rritja e aktivitetit ekonomik botëror në tremujorin e dytë të vitit 2024 është relativisht e qëndrueshme dhe me ngadalësim të mëtjshëm të inflacionit dhe lehtësim gradual përkatës të kushteve monetare. Tensionet gjeopolitike janë ende të pranishme dhe mbeten një nga rreziqet kryesore për perspektivat ekonomike. Në Eurozonë, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, aktiviteti ekonomik ka shënuar një rritje të vogël vjetore edhe në tremujorin e dytë të vitit 2024. Në tremujorin e tretë, inflacioni në nivel global regjistroi një prirje ngadalësuese, nën ndikimin e presioneve të reduktuara nga çmimet e ushqimeve dhe të energjisë. Në këto kushte, politika monetare në disa nga vendet e zhvilluara në tremujorin e tretë filloi me ulje graduale të normave të interesit. Në bursat botërore, në tremujorin e tretë të vitit 2024, çmimet e produkteve primare (nafta, ushqimi dhe metalet) shënuan rënie tremujore. Në përputhje me parashikimet e OECD-së për shtatorin 2024, rritja ekonomike globale pritet të stabilizohet në 3.2% në vitet 2024 dhe 2025, në kushtet e uljes së mëtjshme të inflacionit, përmirësimit të të ardhurave reale dhe politikës monetare më pak kufizuese. Për më tepër, krahasuar me projeksionet e majit, pritjet për rritjen globale në vitin 2024 janë rishikuar në rritje me 0,1 p.p., ndërsa ato për vitin 2025 janë të pandryshuara. Inflacioni edhe më tej do të vazhdojë të ulet, por pak më shpejt në krahasim me vlerësimet e mëparshme.

Aktiviteti ekonomik global regjistroi lëvizje kryesisht të favorshme dhe të qëndrueshme edhe në tremujorin e dytë të vitit 2024, në kushte të ngadalësimit të inflacionit dhe të lehtësimit gradual të kushteve monetare, por me tensione gjeopolitike ende të pranishme. Në kuadër të **vendeve të zhvilluara**, SHBA-të vijnë të arrijnë rritjen më të lartë, prej 3.1%, e cila përshpejtohet në këtë tremujor (2.9% në tremujorin paraardhës), për shkak të rritjes më të fuqishme të kërkesës së brendshme, pra tendencave më të favorshme të konsumit personal, ndërsa performanca më e mirë në investimet bruto e shpjegon rritjen e përshpejtuar në Mbretërinë e Bashkuar, e cila arrin në 0.9% (kundrejt 0.3% në tremujorin e parë). Në Eurozonë, rritja e ndjek të njëjtën dinamikë (0.6% kundrejt 0.5% në tremujorin e parë), por faktori kryesor për përshpejtimin janë lëvizjet pozitive në eksportet neto. Rënia e ekonomisë së Japonisë vijon edhe në tremujorin e dytë, duke u ulur në 0.9% (rënie prej 1.0% në tremujorin e mëparshëm) dhe ngadalësimi është për shkak të realizimeve më të mira të kërkesës së brendshme. Rritje e aktivitetit ekonomik është vërejtur edhe në vendet e grupit të **ekonomive me rritje të shpejtë**, por në përgjithësi është në ngadalësim. Kështu, rritja në Kinë arriti në 4.7% (5.3%, në tremujorin e parë), në kushtet e konsumit të dobët dhe problemeve të mëtjshme në sektorin e pasurive të paluajtshme, kurse rritja e ekonomisë indiane u ul në 6.8% (8.1% në tremujorin e mëparshëm), nën ndikimin e rënies së konsumit publik dhe rritjes së ngadaltë të investimeve bruto. Në ndryshim nga ekonomitë e përmendura, në Brazil rritja e aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2024 u përshpejtua lehtë dhe arriti në 2.8% (2.1% në tremujorin e mëparshëm), nën ndikimin e arritjeve më të mira të kërkesës së brendshme.

¹ Në kuadër të këtij raporti, të dhënat e PBB-së për vitin 2022 dhe 2023 (tremujore dhe vjetore) janë përdorur nga njoftimi tremujor për PBB-në i ESHS-së i publikuar më datë 04.09.2024.



Për sa i përket vlerësimeve për rritjen globale në tremujorin e tretë të vitit 2024, vlera mesatare e indeksit global PMI është 52.4 (53.0 në tremujorin e dytë), duke treguar për tendenca paksa më pak të favorshme të aktivitetit ekonomik botëror në periudhën e ardhshme. Në bazë vjetore, indeksi global PMI shënoi rënie prej 2.5%.



Rritja² ekonomike globale do të stabilizohet në 3.2% në vitin 2024 dhe do të qëndronte në të njëjtin nivel edhe në vitin 2025, në kushtet e uljes së presioneve të inflacionit dhe përmirësimit të të ardhurave reale, uljes graduale të kufizimit të politikës monetare, por tensionet ende janë të pranishme nga lufta me Ukrainën dhe konfliktet në Lindjen e Mesme. Njëkohësisht, krahasuar me projeksionet e majit, pritjet për rritje në vitin 2024 janë rishikuar në rritje me 0.1 p.p., ndërkohë që nuk ka ndryshime për vitin 2025. Inflacioni³ do të vijonte të zvogëlohej, pak më shpejt se sa pritej, dhe në vitin 2024 dhe 2025 do të ulje përkatësisht në 5.4% dhe 3.3%, në kushtet e uljes së presioneve në tregun e punës dhe rënies së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë. Rreziqet në lidhje me rritjen e parashikuar ekonomike globale janë të balancuara, ndërsa rreziqet e rënies janë të lidhura me konfliktet e vazhdueshme gjeopolitike dhe tensionet tregtare, më e fuqishmja nga përshtatja e parashikuar e rënies në tregjet e punës, si dhe ritmi më i ngadaltë i ngadalësimit të inflacionit, që sërisht mund t'i nxisë pritshmëritë e inflacionit. Rreziqet e rritjes lidhen me rritjen e besimit të konsumatorëve, si dhe me rënien ndoshta më të fuqishme se sa ishte parashikuar të çmimeve të naftës, e cila mund të çojë në ulje më të shpejtë të inflacionit dhe ulje më të shpejtë të normave të interesit.


Inflacioni në nivel global shënon kryesisht tendencë ngadalësuese, në kushtet e uljes së presioneve të çmimeve të ushqimit dhe energjisë. Nga grupi i vendeve të zhvilluara, inflacioni mesatar në SHBA dhe Eurozonë në dy muajt e parë të tremujorit të tretë u ngadalësua në përkatësisht 2.7% dhe 2.4% (përkatësisht 3.2% dhe 2.5%, në tremujorin e dytë), nën ndikimin e presioneve të reduktuara nga çmimet e ushqimit dhe energjisë. Përkundrajt kësaj, inflacioni në dy muajt e parë të tremujorit të tretë

² Analiza në këtë seksion bazohet në raportin e OECD-së për "Perspektivat ekonomike", të publikuar në shtator të vitit 2024.


³ Projektioni i inflacionit i referohet vendeve të G20-së dhe krahasuar me parashikimet e majit është më i ulët me 0.5 p.p. dhe 0.3 p.p. respektivisht në vitet 2024 dhe 2025.

në Mbretërinë e Bashkuar dhe në korrik në Japoni u rrit lehtësisht në përkatësisht 3.1% dhe 2.8%, (përkatësisht 2.9% dhe 2.7% në tremujorin e mëparshëm).

Norma e inflacionit në vendet e zhvilluara
(ndryshimi vjetor procentual; të dhëna mujore)



Papunësia në ekonomitë e zhvilluara
(në përqindje; të dhëna të desezonuara mujore)



Në Eurozonë, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, aktiviteti ekonomik shënoi një rritje të vogël vjetore prej 0.6% në tremujorin e dytë të vitit 2024, por që vazhdon të përshpejtohet (rritje prej 0.5% në tremujorin e mëparshëm). Në të njëjtën kohë, përshpejtimi minimal i rritjes është rezultat i kontributit pozitiv të eksportit neto, me shtim të rritjes së eksporteve, pjesërisht i kompensuar nga kërkesa e dobët e brendshme, kryesisht si pasojë e rënies më të fuqishme të investimeve bruto. Rritja në Eurozonë ka qenë më e ulët se sa pritej, duke shkaktuar rishikim në rënie për vitet 2024, 2025 dhe 2026 në projeksionet e shtatorit të BQE-së. Kështu, për vitin 2024, rritja ekonomike e Eurozonës pritet të jetë 0.8%, dhe përshpejtimi gradual i saj në 1.3% dhe 1.5% përkatësisht⁴ për vitet 2025 dhe 2026.

Lëvizjet në tregun e punës në Eurozonë janë përgjithësisht të qëndrueshme, duke pasur parasysh se shkalla e papunësisë në tremujorin e tretë u ul minimalisht në një nivel historikisht të ulët prej 6.4% (6.5% në tremujorin e dytë). Norma vjetore e inflacionit në Eurozonë në dy muajt e parë të tremujorit të tretë 2024 është mesatarisht 2.4% dhe është minimalisht më e ulët se ajo e tremujorit të dytë (2.5%). Me projeksionet e fundit të shtatorit të BQE-së, nuk u bë asnjë ndryshim në pritjet, kështu që norma e inflacionit në vitin 2024 do të ishte 2.5%, pas së cilës do të pasonte ngadalësimi i saj i mëtejshëm dhe do të zvogëlohej në 2.2% në 2025 dhe 1.9% në vitin 2026.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara filluan ta lehtësojnë gradualisht shkallën e kufizimit të politikës monetare, në kushte të ngadalësimit të normës së inflacionit dhe perspektivave për uljen e inflacionit në afat të mesëm në nivelin e pritur, si dhe për ta mbështetur aktivitetin ekonomik. BQE-ja, krahas uljes në qershor të vitit 2024, në shtator e uli normën e interesit për depozitat e disponueshme me 0.25 p.p., ndërsa normat për kreditë e disponueshme njëditore dhe për operacionet bazë të rifinancimit janë ulur me 0.6 p.p., në përputhje me ndryshimet në kuadrin operativ⁵. Për rrjedhojë, norma e interesit për depozitat e disponueshme, për operacionet bazë të rifinancimit dhe për kreditë e disponueshme njëditore u vendos përkatësisht në nivelet 3.50%, 3.65% dhe 3.90%. Në të njëjtën kohë, portofoli në kuadër të Programit për blerjen e letrave me vlerë (APP) vijon të ulet gradualisht dhe me ritme të parashikueshme, për shkak se kryegjëja (principali) i letrave me vlerë të maturuara nuk riinvestohet më, ndërsa portofoli nga Programi për blerjen e letrave me vlerë për mbështetje të menjëhershme të ekonomisë për shkak të pandemisë (PEPP) do të reduktohet mesatarisht me 7.5 miliardë euro në muaj, deri në ndërprerjen e plotë të riinvestimeve në kuadër të këtij programi në fund të vitit 2024. Në shtator, për herë të parë në katër vjet, FED-i e uli


⁴ Sipas projeksionit të qershorit 2024, rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik ishte 0.9% në 2024, 1.4% në 2025 dhe 1.6% në vitin 2026.

⁵ Sipas ndryshimit të fundit në kuadrin operacional për zhvillimin e politikës monetare të BQE-së të datës 13.03.2024, i cili ka hyrë në fuqi më 18.09.2024, norma e interesit për depozitat e disponueshme do të përdoret si normë bazë e interesit për zhvillimin e politikës monetare, kurse niveli i dy normave të tjera të interesit do të përcaktohet me një diferencë fikse, në mënyrë që diferenca ndërmjet normës së interesit të operacioneve bazë të rifinancimit dhe depozitave të disponueshme të ulet dhe të arrijë në 0.15 p.p., kurse intervali ndërmjet normës së interesit të kredive të disponueshme njëditore dhe operacioneve bazë të rifinancimit do të mbetet e pandryshuar, pra 0.25 p.p. ([lidhje interneti](#)).

normën referencë të interesit me 0.5 p.p. dhe e reduktoi atë në intervalin nga 4.75% deri në 5.0%, në kushtet e uljes së presioneve të inflacionit, zbutjes së rreziqeve për rritje të inflacionit, por edhe rreziqeve në rënie për aktivitetin ekonomik. Përveç kësaj, FED-i do të vazhdojë ta zvogëlojë më tej portofolin e tij të thesareve dhe të letrave me vlerë të mbështetura nga hipoteka, siç ka bërë deri më tani.

Banka e Anglisë gjithashtu e uli normën referencë të interesit me 0.25 p.p. dhe është 5.0%. Përkundrejt kësaj, Banka e Japonisë në tremujorin e tretë të vitit 2024 e rriti normën bazë të interesit, nga 0,1% në 0,25%, në kushtet e rritjes së presioneve të çmimeve dhe pritjeve të inflacionit, dhe në të njëjtën kohë e miratoi dhe planin për ta reduktuar sasinë e blerjes mujore të letrave me vlerë të qeverisë me rreth 400 miliardë jen japonezë çdo tremujor, kështu që në tremujorin e parë të vitit 2026 blerja do të arrijë në rreth 3 trilion jen.

Norma referente e interesit në vendet e zhvilluara
(në %)



Kursi valutor ShBA dollar/EUR
(të dhëna mujore, mesatare)





Në tremujorin e tretë të vitit 2024, vlera e dollarit amerikan kundrejt euros ra me 2,0% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2024, si rezultat i pritjeve të tregut për ulje të normave të interesit nga FED-i. E parë në bazë vjetore, dollari amerikan shënon zhvlerësim me 1.0%, duke arritur mesatarisht në 0.91 euro gjatë kësaj periudhe.

Çmimet e produkteve primare në bursat botërore, të shprehura në euro, në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan rënie. Kështu, çmimi mesatar i naftës në këtë periudhë është 71.7 euro për fuçi dhe është më i ulët për 9.2% krahasuar me tremujorin paraardhës, përkatësisht me 9.4% në bazë vjetore. Lëvizja rënëse e çmimit të naftës vjen si pasojë e uljes së kërkesës globale, veçanërisht nga SHBA-të dhe Kina, pavarësisht vendimit të OPEC+ për ta filluar rritjen e prodhimit më vonë, pra nga dhjetori në vend të tetorit të këtij viti. Gjithashtu, indeksi i çmimeve të produkteve⁶ primare jo energjetike (i shprehur në euro) shënoi një rënie prej 4,1% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2024. Shikuar sipas grupeve të produkteve, indeksi i çmimeve të metaleve⁷ bazë dhe ai i ushqimit⁸ ranë përkatësisht me 8.6% dhe 6.2%.



⁶ Ky indeks total e përfshin indeksin e metaleve të çmuara, indeksin e ushqimeve dhe pijeve, indeksin e lëndëve të para bujqësore dhe indeksin e metaleve bazë.

⁷ Në këtë indeks përfshihen metalet e mëposhtme: alumini, kobalti, bakri, hekuri, plumbi, molibdeni, nikeli, kallaji, uranumi dhe zinku.

⁸ Në këtë indeks përfshihen produktet e mëposhtme ushqimore primare: drithërat, vaji vegjetal, mishi, ushqimet e detit, sheqeri dhe ushqime të tjera.



Për sa i përket vendeve të rajonit, rritja ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2024 vazhdon, pak më e fuqishme në Bullgari e nxitur nga investimet bruto, ndërsa më e moderuar në Kroaci, Serbi dhe Ruman, kryesisht për shkak të përkeqësimit të eksportit neto. Inflacioni vijon të ngadalësohet në tremujorin e tretë të vitit 2024 në të gjitha vendet e analizuara të rajonit, kryesisht nën ndikimin e ngadalësimit të rritjes së çmimeve të lëndëve djegëse.



1.2. Oferta e brendshme

Me realizimet e mëtejshme të favorshme në grupin e veprimtarive "tregti, transport dhe hotelieri", rritjen e aktivitetit në ndërtim, si dhe tendencat negative dukshëm më të moderuara në bujqësi, rritja e aktivitetit në ekonominë vendase në tremujorin e dytë të vitit 2024 u përshpejtua në bazë vjetore dhe arriti në 2.3% (1.2% në tremujorin paraardhës). Megjithatë, realizimet në një nga aktivitetet kryesore – industri, edhe këtë tremujor mbetën në zonën negative. Në bazë tremujore, aktiviteti ekonomik shënoi një rritje reale prej 0.8%. Të dhëna me frekuencë të lartë nga ana e ofertës që disponohen për periudhën korrik-gusht tregojnë për rritje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik. Të ngjashme janë edhe vlerësimet e drejtuesve në lidhje me situatën e biznesit të ndërmarrjeve për tremujorin e tretë të vitit 2024, të cilat janë më të favorshme në tregti, ndërtimtari dhe në sektorin e shërbimeve, ndërsa në industri janë më pak të favorshme. Për periudhën e ardhshme pritshmëritë e drejtuesve të kompanive në të gjithë sektorët janë më të favorshme.



Në tremujorin e dytë të vitit 2024, rritja reale e PBB-së arrin në 2.3% në bazë vjetore (rritje prej 1.2% në tremujorin e mëparshëm), me rritje në bazë tremujore prej 0.8% (e përshtatur sezonale dhe kalendarike). Rritja përshpejtohet në bazë vjetore, me arritje të mëtijshme të favorshme në grupin e aktiviteteve "tregti, transport dhe hotelieri", rritje të aktivitetit ndërtimor, si dhe lëvizje negative dukshëm më të moderuara në bujqësi. Nga ana tjetër, arritjet e industrisë edhe këtë tremujor kanë mbetur në zonën negative.

PBB-ja dhe komponentët - normat vjetore të rritjes (në %)

	normat vjetore të rritjes, në %*							
	2019	2020	2021	2022	2023	Tr.1 2024	Tr.2 2024	Gjy.1 2024
Bujqësi	0.1	2.5	-8.7	-5.0	-3.8	-19.7	-3.2	-10.7
Industri	1.4	-6.7	2.2	-1.2	-0.1	-1.2	-2.1	-1.7
nga të cilat në industrinë përpunuese	2.6	-4.8	6.1	-2.7	-0.8	-0.2	0.7	0.3
Ndërtimtari	5.5	-4.0	-6.0	8.1	-2.3	-2.5	5.1	1.4
Tregti, transport dhe trafik dhe hotelieri	6.7	-10.6	7.6	0.0	3.0	6.9	5.8	6.3
Informacione dhe komunikime	6.8	4.5	12.2	15.1	4.4	2.5	2.3	2.4
Ndërmjetësimi financiar	0.4	-0.1	-0.1	-1.4	4.4	-0.1	1.1	0.5
Veprimtari që lidhen me pasuritë e paluajtshme	0.2	1.1	7.0	19.0	3.7	0.1	0.9	0.5
Veprimtaritë administrative dhe të shërbimeve ndihmëse	8.0	-8.7	14.5	9.2	3.2	7.5	8.7	8.1
Administrata publike	5.2	3.2	4.0	-7.2	-1.4	0.7	-0.1	0.3
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari të tjera shërbimi	9.6	-22.6	17.2	8.4	0.6	19.6	9.5	14.4
Prodhimi i brendshëm bruto	3.9	-4.7	4.5	2.2	1.0	1.2	2.3	1.8

* Nga njoftimi për PBB-në i datës 04.09.2024



Burimi: Enti shtetëror i statistikave

PBB-ja dhe komponentët – kontributi në rritjen e PBB-së (në p.p.)



	kontributi në rritjen e PBB, në p.p.							
	2019	2020	2021	2022	2023	Tr.1 2024	Tr.2 2024	Gjy.1 2024
Bujqësia	0.0	0.2	-0.7	-0.4	-0.3	-1.2	-0.2	-0.5
Industria	0.3	-1.2	0.4	-0.2	0.0	-0.2	-0.3	-0.2
nga të cilat në industrinë përpunuese	0.3	-0.6	0.8	-0.4	-0.1	0.0	0.1	0.0
Ndërtimtari	0.3	-0.2	-0.3	0.5	-0.1	-0.1	0.2	0.1
Tregti, transport dhe trafik dhe hotelieri	1.3	-2.1	1.5	0.0	0.6	1.3	1.1	1.2
Informacione dhe komunikime	0.2	0.2	0.5	0.6	0.2	0.1	0.1	0.2
Ndërmjetësimi financiar	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
Veprimtari që lidhen me pasuritë e paluajtshme	0.0	0.1	0.7	2.0	0.4	0.0	0.1	0.1
Veprimtaritë administrative dhe të shërbimeve ndihmëse	0.3	-0.3	0.5	0.4	0.1	0.3	0.4	0.5
Administrata publike	0.6	0.4	0.5	-0.9	-0.2	0.2	0.0	0.0
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari të tjera shërbimi	0.3	-0.7	0.5	0.2	0.0	0.6	0.3	0.5
Prodhimi i brendshëm bruto	3.9	-4.7	4.5	2.2	1.0	1.2	2.3	1.8

Burimi: Përlogaritjet e BPRMV-së.


Analizuar nga të dhënat me frekuencë të lartë, në tremujorin e dytë të vitit, **qarkullimi i përgjithshëm në tregti shënoi një rritje të vogël reale në bazë vjetore**, në kushte të rritjes së tregtisë me pakicë dhe tregtisë së automjeteve, ndërsa tregtia me shumicë shënoi rënie të lehtë. Në periudhën korrik-gusht, qarkullimi i përgjithshëm në tregti shënoi rritje të përshpejtuar, mbështetur nga rritja e tregtisë me pakicë dhe tregtisë së automjeteve, ndërsa rënia në tregtinë me shumicë u thellua. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e "tregtisë me pakicë" në lidhje me situatën e biznesit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 janë më të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, gjithashtu, më të favorshme janë edhe pritjet për periudhën e ardhshme.



Për sa i përket **transportit**, në tremujorin e dytë të vitit 2024 është shënuar rënie reale në trafikun rrugor të pasagjerëve, në atë hekurudhor dhe ajror, si dhe në trafikun hekurudhor të mallrave, ndërsa në trafikun rrugor të mallrave është vërejtur rritje reale e lartë.




Në kuadër të **sektorit të hotelierisë**, në tremujorin e dytë të vitit 2024, numri i turistëve dhe fjetjeve vijon të shënojë rritje reale solide në bazë vjetore, si dhe xhiroja totale në hotelieri. Të dhënat e korrikut 2024 tregojnë për rritje të mëtejshme të numrit të turistëve dhe fjetjeve, si dhe të xhiros totale në hotelieri. Vlerësimet e drejtuesve të kompanive të sektorit të shërbimeve për gjendjen e biznesit të tyre në tremujorin e tretë të vitit 2024 janë më të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, por dhe pritshmëritë për periudhën në vijim për sa i përket kërkesës janë më të favorshme.



Në tremujorin e dytë të vitit 2024, prodhimi⁹ industrial shënoi një rënie prej 7.1% në bazë vjetore, që paraqet një thellim krahasuar me tremujorin paraardhës, kur rënia arriti në 3%. Realizimi është kryesisht rezultat i kontributit negativ të industrisë së përpunimit dhe sektorit të energjetikës, dhe në një masë më të vogël edhe i xehetarisë. Shikuar sipas veprimtarive, në kuadër të industrisë përpunuese, kontributin më të rëndësishëm negativ e ka prodhimi i veshjeve dhe prodhimi i produkteve të duhanit. Nga ana tjetër, kontributin më të rëndësishëm pozitiv e ka prodhimi i produkteve të tjera minerale jo metalike. Në periudhën korrik-gusht, prodhimi industrial shënoi një rritje të vogël, si pasojë e rritjes së prodhimit në industrinë përpunuese, ndërsa sektori i xehetarisë dhe ai i energjetikës patën kontribute negative. Drejtuesit e sektorit industrial kanë vlerësime më pak të favorshme për situatën e biznesit në tremujorin e tretë të vitit 2024 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa pritjet për lëvizjen e prodhimit në periudhën e ardhshme janë më të favorshme.


⁹ Analiza e lëvizjeve në industri është bërë mbi bazën e të dhënave mujore për indeksat e prodhimit industrial të ESHS-së.

Kontributet e veprimtarive të zgjedhura në ndryshimin vjetor të prodhimit industrial (në pikë përqindje)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe BPRMV-së.

Sipas të dhënave të disponueshme me frekuencë të lartë, **në tremujorin e dytë të vitit 2024, aktiviteti në sektorin e ndërtimtarisë shënoi një rritje të lartë reale në bazë vjetore, që paraqet një përshpejtim në raport me rritjen në tremujorin e kaluar.** Në të njëjtën kohë, rritja në totalin e punimeve të ndërtimit i detyrohet në masën më të madhe rritjes së ndërtimeve të ulëta, sipas aktiviteteve të intensifikuara të ndërtimit në lidhje me infrastrukturën rrugore, dhe në një masë më të vogël nga rritja e punimeve¹⁰ të specializuara të ndërtimit, ndërsa ndërtimet e larta shënuan rënie. Në korrik, ndërtimtaria shënoi rritje të mëtjeshme, tërësisht si rezultat i rritjes së ndërtimeve të ulëta, por me dinamikë më të moderuar. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimtarisë për lëvizjen e aktivitetit të tyre në tremujorin e tretë të vitit 2024, si dhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme, janë më të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe logaritje të BPRMV-së.




Source: Construction survey of EC, State Statistical Office and NBRNM.

¹⁰ Punimet e specializuara të ndërtimit janë një kategori brenda të dhënave për punët e kryera në ndërtimtari dhe përfshin "prishjen dhe përgatitjen e kantierit", "instalimet elektrike, hidraulike dhe të kanalizimeve dhe punime të tjera instaluese ndërtimore", "punime përfundimtare në ndërtimtari" dhe "gjëra të tjera të specializuara ndërtimore".


1.3. Kërkesa totale

Nga aspekti i kërkesës, rritja reale vjetore e PBB-së prej 2.3% në tremujorin e dytë të vitit 2024 rezulton më së shumti nga kontributi pozitiv i eksporteve neto, në kushtet e një rënie më të fuqishme reale të importit sesa rënia e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Kontribut të vogël pozitiv ka pasur edhe kërkesa e brendshme, më së shumti si rezultat i rritjes së konsumit të amvisërive, i cili ende mbështetet nga rritja e të ardhurave të disponueshme dhe kreditimi nga bankat, kurse rritje ka shënuar edhe konsumi publik. Nga ana tjetër, investimet më të ulëta në stoqe çuan në rënie të investimeve bruto këtë tremujor, pas rritjes së lartë në tremujorin e mëparshëm.

Analiza strukturore e PBB-së¹¹ nga aspekti i kërkesës tregon se në tremujorin e dytë të vitit 2024, rritja më së shumti rezulton nga kontributi pozitiv i eksportit neto, ndërsa një kontribut të vogël pozitiv ka edhe kërkesa e brendshme. Parë nga këndvështrimi i komponentëve të veçantë, në këtë tremujor ka pasur rënie të vogël të eksportit, i cili në kushtet e rënies më të theksuar të importit, ka kontribuar pozitivisht në eksportin neto. Bartësi kryesor i rritjes së kërkesës së brendshme është konsumi personal, por rritja e tij vazhdon të ngadalësohet, ndërsa kontribut pozitiv shtesë shënon konsumi publik. Nga ana tjetër, pas rritjes së lartë në tremujorin paraardhës, investimet bruto në këtë tremujor shënuan rënie për shkak të reduktimit të stoqeve, me rritjen e investimeve në mjete themelore.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

¹¹ Ndryshimet tremujore të PBB-së dhe të përbërësve të tij llogariten nga të dhënat e përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së.



Normat vjetore të rritjes reale (në %)										Kontributet në rritjen reale vjetore (në p.p.)**								
	2021	2022	2023	2023-Tr.1	2023-Tr.2	2023-Tr.3	2023-Tr.4	2024-Tr.1	2024-Tr.2	2021	2022	2023	2023-Tr.1	2023-Kë.2	2023-Kë.3	2023-Tr.4	2024-Tr.1	2024-Tr.2
Konsumi personal	8.8	3.8	2.4	0.7	2.8	2.8	3.3	2.0	1.3	5.7	2.6	1.7	0.5	1.9	2.0	2.2	1.4	1.0
Konsumi publik	0.9	-5.0	-0.6	-4.3	-1.1	-3.0	5.6	2.4	3.5	0.1	-0.8	-0.1	-0.7	-0.2	-0.5	0.8	0.5	0.5
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	14.3	11.4	-0.1	6.6	-1.4	-5.0	0.1	-7.8	-2.9	8.2	7.5	-0.1	4.8	-1.0	-3.8	-0.1	-6.1	-2.1
Importi i mallrave dhe shërbimeve	14.8	12.4	-5.8	-5.0	-2.0	-9.8	-6.5	0.2	-4.5	-10.4	-10.1	5.5	4.7	1.9	9.3	6.1	-0.1	4.1
Investimet bruto	3.7	9.4	-16.7	-22.3	-4.8	-18.7	-20.5	23.6	-1.7	0.9	3.0	-6.0	-8.0	-1.7	-6.0	-8.2	5.6	-1.2
Kërkesa e brendshme	6.5	4.2	-3.1	-6.0	0.3	-3.0	-3.6	6.8	0.6	6.7	4.8	-4.4	-8.2	0.0	-4.5	-5.2	7.5	0.3
Eksporti neto*	16.3	15.2	-21.6	-35.8	-3.8	-26.3	-21.3	35.8	-8.9	-2.2	-2.6	5.4	9.5	0.9	5.5	6.0	-6.2	2.0
Mospërputhje statistikore										0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
PBB	4.5	2.2	1.0	1.4	0.9	1.0	0.9	1.2	2.3	4.5	2.2	1.0	1.4	0.9	1.0	0.9	1.2	2.3

* rënia e eksporteve neto tregon ngushtim të deficitit

** Kontributet sipas komponentëve nuk shtohen në PBB-në totale për shkak të mospërputhjes statistikore në shumat aktuale.

Në mënyrë që të përputhet me normat zyrtare të rritjes reale, në PBB-në totale përfshet mospërputhja statistikore.

Burimi: Enti shtetëror për statistikë dhe llogaritjet e BPRMV-së.

1.3.1. Konsumi personal

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, konsumi personal është nxitësi kryesor i rritjes së kërkesës së brendshme, por rritja vjetore vazhdon të ngadalësohet dhe arrin në 1.3% (rritje tremujore prej 0.5%). Konsumi personal mbështetet nga të ardhurat e disponueshme reale, të cilat vazhdojnë të rriten, por në mënyrë më të moderuar, në kushtet e rritjes më të ngadaltë të masës së pagave¹² dhe të masës së pensione¹³. Nga ana tjetër, transfertat private vijnë të shënojnë rënie reale, por disi më pak krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Një pjesë e konsumit të individëve financohet ende nëpërmjet kredive nga bankat, të cilat shënuan një rritje më të lartë reale vjetore këtë tremujor. Dhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, ishin ende të vlefshme disa nga masat ekonomike të miratuara në fund të vitit 2023 për mbrojtjen e standardeve¹⁴ të jetesës për ta ruajtur konsumin e amvisërive.

Nga aspekti i të dhënave të disponueshme për konsumin¹⁵ personal për tremujorin e tretë të vitit 2024, ato tregojnë për rritjen e mëtejshme të tij. Këtë e tregon rritja e mëtejshme e disa komponentëve të të ardhurave të disponueshme, pra në paga dhe pensione, si dhe në kreditë e popullsisë. Rezultatet e anketës për aktivitetin kreditor të muajit shtator tregojnë për një lehtësim neto të kushteve të kreditimit dhe një rritje neto të kërkesës për kredi të amvisërive. Rritje e përsheptuar është vërejtur në importin e mallrave për konsum të gjerë, tregtinë me pakicë dhe prodhimin vendas të mallrave të konsumit, ndërkohë që të ardhurat bruto nga TVSH-ja kanë vazhduar të rriten, por pak më


¹² Më shumë detaje në seksionin 1.3. Punësimi dhe pagat

¹³ Në mars të vitit 2024, pensionet u rritën me 5.3%, në përputhje me harmonizimin e rregullt me metodologjinë, e cila ndjek dy tregues, pra 50% të rritjes së pagës mesatare dhe 50% të rritjes së kostos së jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave. Ky harmonizim bëhet dy herë në vit, në mars dhe shtator (për më shumë shih në vijim në lidhje).

¹⁴ Më 9 dhjetor të vitit 2023, Qeveria miratoi një paketë tjetër masash antikrizë të ndara në 4 kategori: 1) Masa në mbështetje të qytetarëve dhe amvisërive (mbështetje për nxënësit dhe studentët nga familjet me të ardhura të ulëta, mbështetje për kategoritë e qytetarëve në nevojë, pensionistët dhe familjet me të ardhura më të ulëta, mbështetje për fermerët); 2) Masa për mbështetjen e ekonomisë (kredi më të favorshme për likuiditet dhe investime, subvencionimi i kontributeve për paga më të larta); 3) Masa për mbështetjen e sektorit publik (komunat dhe ndërmarrjet publike); dhe 4) Masa sistematike që kontribuojnë në zbutjen e efekteve të krizës së çmimeve dhe të energjetikës. (<https://finance.gov.mk>)

¹⁵ Të dhënat për pagat janë deri në korrik të vitit 2024, ndërsa të dhënat për kreditë e popullsisë, pensionet, tregtinë me pakicë, prodhimin vendas të mallrave të konsumit, importet e mallrave të konsumit dhe të ardhurat bruto nga TVSH-ja i referohen periudhës korrik - gusht 2024.


ngadalë. Për sa i përket treguesit të besimit të konsumatorëve¹⁶, ai tregon për perceptime më të favorshme për tremujorin e tretë të vitit 2024, si në krahasim me tremujorin paraardhës, ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2023.



1.3.2. Konsumi publik

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, rritja e konsumit publik u përshpejtua dhe arriti në 3.5% (2.4% në tremujorin paraardhës), me një rritje tremujore prej 1%. Sipas të dhënave nga buxheti, në këtë periudhë është vërejtur rritje reale në të gjitha kategoritë kryesore të konsumit publik.

Arritjet në buxhet për periudhën korrik - gusht 2024 tregojnë për rritje të mëtejshme reale vjetore të konsumit publik, por më të ngadaltë, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe të transfertave në Fondin e Shëndetësisë.





1.3.3. Konsumi për investime

Pas rritjes së fuqishme vjetore prej 23.6% të investimeve bruto në tremujorin e parë të vitit 2024, në tremujorin e dytë ato arritën një rënie reale vjetore dhe tremujore përkatësisht prej 1.7% dhe 0.8%. Lëvizjet me bazë vjetore janë rezultat i reduktimit të stokeve, ndërkohë që rriten investimet në mjete themelore. Shikuar përmes kategorive treguese për investimet

¹⁶ Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve deri në shtator të vitit 2024. Në shfaqjen grafike, indeksi i besimit të konsumatorit shfaqet si përqindje neto e përgjigjeve. Ky indeks është një komponent përbërës i indeksit të përgjithshëm të besimit ekonomik.

në mjete themelore, punimet e përfunduara të ndërtimit dhe kreditë afatgjata të ndërmarrjeve në tremujorin e dytë shënuan rritje të përshpejtuar. Tek importi i kapitalit qarkullues, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe investimet e drejtpërdrejta të huaja, edhe më tej ka rritje, por më të ngadaltë se në tremujorin e mëparshëm. Nga ana tjetër, investimet kapitale shtetërore, pas rritjes në tremujorin paraardhës, në këtë tremujor kanë shënuar rënie reale, ndërsa rënie reale ka shënuar edhe prodhimi vendas i produkteve kapitale.

Në lidhje me të dhënat me frekuencë të lartë për investimet¹⁷ bruto për periudhën korrik - gusht 2024, vërehet rritje e përshpejtuar e mbështetjes kreditore të ndërmarrjeve, e cila është në përputhje me rezultatet e Anketës për aktivitetin kreditor për tremujorin e tretë të vitit 2024, të cilat tregojnë një lehtësim neto të kushteve të përgjithshme të kreditimit, me rritje neto të kërkesës për kredi për korporatat. Në këtë periudhë ka zhvillime më të favorshme edhe në industri, kështu që pas rënies në tremujorin paraardhës, ka rritje të prodhimit të përgjithshëm industrial, ndërsa prodhimi vendas i produkteve kapitale është i qëndrueshëm. Rritje, edhe pse më e ngadaltë, është shënuar në punimet e ndërtimit dhe tatimin mbi fitimin. Nga ana tjetër, investimet kapitale shtetërore shënuan rënie të mëtejshme, por dukshëm më të vogël, ndërsa rënie, përkundërt rritjes në tremujorin e dytë, u vu re edhe tek importi i kapitalit qarkullues dhe stoqet e produkteve të gatshme.





1.3.4. Kërkesa neto për eksport

Pas kontributit negativ në tremujorin e parë të vitit 2024, eksporti neto në tremujorin e dytë pati kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së, në kushtet e rënies më të fuqishme reale të importit sesa eksporti i mallrave dhe shërbimeve. Kështu, eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi një rënie reale vjetore prej 2.9% në tremujorin e dytë të vitit 2024 (rritje tremujore prej 0.6%). Në kushtet e rënies së eksportit dhe rritjes shumë të vogël të kërkesës së brendshme, importi shënoi rënie në tremujorin e dytë prej 4.5% në bazë vjetore (me rënie tremujore prej 1.7%).

Të dhënat për shkëmbimin në tregtinë e jashtme për periudhën korrik - gusht të vitit 2024 tregojnë për rritje të mundshme të deficitit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me rritjen më të lartë nominale të importit sesa eksporti i mallrave.

¹⁷ Të dhënat për punët e përfunduara ndërtimore dhe stoqet e mallrave të gatshme janë deri në korrik të vitit 2024, ndërsa të dhënat për kreditë afatgjata të ndërmarrjeve, investimet kapitale qeveritare, prodhimin industrial, importet e produkteve të investimeve dhe prodhimin vendas të produkteve kapitale i referohen periudhës korrik - gusht të vitit 2024.




1.4. Punësimi dhe pagat

Tregu i punës në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënoi lëvizje të moderuara pozitive në bazë vjetore. Kështu, shkalla e punësimit arriti në 45.6%, që përfaqëson një rritje prej 0.1 p.p. krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, në kushte të rritjes së numrit të të punësuarve me 0.3%. Rënia e shkallës së papunësisë është më e fuqishme (me 0.6 p.p.), duke zbritur në nivelin 12.5%, me rënie vjetore të numrit të personave të papunë me 5.3%. Zvogëlimi i të papunëve ka kontribuar në rënien e popullsisë aktive në bazë vjetore (me 0.4%) dhe në rritjen e popullsisë joaktive (me 0.5%). Në përputhje me hulumtimin e anketës, optimizmi mes drejtuesve të biznesit për punësimet e reja në korrik dhe gusht të vitit 2024 është rritur mesatarisht në krahasim me perceptimet e shprehura gjatë tremujorit të dytë. Në raport me koston e punës, pagat në tremujorin e dytë të vitit 2024 kanë vijuar të rriten në bazë vjetore, por më ngadalë krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, në tregun e punës¹⁸ vërehen lëvizje të moderuara pozitive në bazë vjetore. Kështu, shkalla e punësimit u rrit në 45.6%, që është më shumë me 0.1 p.p. krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, në kushtet e rritjes së numrit të të punësuarve me 0.3%. Porë sipas veprimtarive të veçanta, kontributin më të madh në rritjen vjetore të numrit të të punësuarve e kanë veprimtaritë "bujqësi, pylltari dhe peshkim" dhe "kujdes shëndetësor dhe social", si dhe rritje më të madhe ka në veprimtaritë "profesionale, shkencore dhe teknike", "art, argëtim dhe rekreacion" dhe "industri përpunuese". Për sa i përket statusit¹⁹ ekonomik, ka një rritje vjetore të numrit të të punësuarve në të gjitha kategoritë, përveç kategorisë "punëdhënës", ndërsa rritja më e madhe është në kategorinë "të vetëpunësuar".

¹⁸ Në këtë informacion tremujor, ne e vazhdojmë analizën në baza vjetore bazuar në të dhëna të krahasueshme nga viti 2023 e në vazhdim. Krahasueshmëria me vitet e mëparshme është e kufizuar për shkak të zbatimit të Rregullores së re (BE) nr. 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistika Sociale dhe rregullores ekzekutive përkatëse të Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për fushën e fuqisë punëtore, me ç'ka rregullorja e mëparshme (KE) nr. 577/98 u shfuqizua. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në hulumtim, duke filluar me ndryshime në pyetësor, ndryshime në radhën e pyetjeve, ndryshime dhe heqje të pyetjeve ekzistuese dhe shtim të pyetjeve të reja, ndryshime në shtrirjen dhe përkufizimin e punësimit dhe papunësisë.


¹⁹ Klasifikimi sipas statusit ekonomik u referohet këtyre grupeve: **punëdhënës** - persona që e menaxhojnë subjektin e tyre afarist ose janë pronarë që punojnë në dyqanin e tyre, ose janë pronarë të pronës së tyre bujqësore dhe punësojnë persona të tjerë; **të punësuar** - personat që punojnë në institucione shtetërore, subjekte afariste në pronësi shoqërore, të përzier, kooperativa dhe të papërcaktuar ose të punëdhënës privat; **të vetëpunësuar** - personat të cilët kanë subjekt afarist, biznes, kryejnë veprimtari në mënyrë të pavarur dhe punojnë në pronë bujqësore për të krijuar të ardhura dhe nuk punësojnë persona të tjerë; **punëtorë të pagapaguar të familjes** - personat që punojnë pa pagesë në një subjekt afarist, dyqan apo pronë bujqësore (në pronësi të një anëtarit të familjes së tyre).



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Anketa për fuqinë punëtore.

Shënim: Të dhënat nga tremujori i parë i vitit 2023 e në vazhdim përmbajnë ndryshim metodologjik, me çka është bërë shpërndarje statistikore e serisë.

Në muajt korrik dhe gusht të vitit 2024, anketat për tendencat²⁰ e biznesit, mesatarisht, tregojnë kryesisht për pritshmëri më të favorshme nga drejtuesit e subjekteve afariste në drejtim të rritjes së numrit të të punësuarve, krahasuar me perceptimet e shprehura në tremujorin paraardhës dhe në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, pritshmëri më të favorshme ka në të gjithë sektorët përveç industrisë.




Burimi: Komisioni Evropian, Anketat për tendencat e biznesit.

* Pritjet për numrin total të punësimeve gjatë 3 muajve të ardhshëm e udhëheqësve të ndërmarrjeve në industri, sektorin e shërbimeve, tregtinë me pakicë dhe ndërtimin.

Shkalla e vendeve të lira²¹ të punës është relativisht e qëndrueshme, kështu që në tremujorin e dytë të vitit 2024 është 1.9% (2.0% në tremujorin paraardhës). Duke parë sipas veprimtarive, shkallë më të larta të vendeve të lira të punës ka në veprimtaritë "objekte të akomodimit dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit" (3,7%), "ndërtimtari" (3,4%), "tregti" (3,3%) dhe "veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe ndihmëse" (3,2%).

²⁰ Burimi: Komisioni Evropian, anketa mbi tendencat e biznesit, pritjet e punësimit në 3 muajt e ardhshëm në industri, shërbime, tregti me pakicë dhe ndërtimtari (anketime të kryera në korrik dhe gusht të vitit 2024).

²¹ Shkalla e vendeve të lira të punës është raporti midis numrit të vendeve të lira dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Zakonisht, shkalla e vendeve të punës shqyrtohet së bashku me shkallën e papunësisë (relacion i njohur si kurba Beveridge). Vendosja e këtyre dy treguesve jep informacion mbi efikasitetin e tregut të punës përsa i përket mospërputhjeve të mundshme midis profileve të kërkuara dhe atyre të disponueshme në tregun e punës në një moment të caktuar (skill mismatches në anglisht). Konkretnisht, nëse të dy treguesit lëvizin në të njëjtën kohë, bëhet fjalë për luhatje të përkohshme, ciklike, ndërsa në rastin kur shkalla e papunësisë ulet, me shkallë të qëndrueshme të vendeve të lira të punës, bëhet fjalë për ndryshime strukturore, pra për efikasitet më të mirë të tregut të punës.



Shënim: Të dhënat e normës së aktivitetit nga tremujori i parë i vitit 2023 e në vazhdim përmbajnë ndryshim metodologjik, me çka është bërë shkëputje statistikore e serisë.

Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e dytë të vitit 2024 popullsia aktive shënoi rënie prej 0.4% në bazë vjetore, shoqëruar me rritje prej 0.5% të popullsisë joaktive, kështu që shkalla e aktivitetit u ul me 0.2 p.p në bazë vjetore dhe është 52.1%.

Rritja e kërkesës për fuqi punëtore, në kushte të një oferte të reduktuar të fuqisë punëtore, çoi në ulje më të ndjeshme të papunësisë në tremujorin e dytë të vitit 2024. Kështu, numri i të papunëve u zvogëlua me 5.3% në bazë vjetore, gjë që shkaktoi ulje të shkallës së papunësisë, e cila u zvogëlua në 12.5% (13.1% në tremujorin e dytë të vitit 2023).


Paga mesatare e paguar në vend ka vijuar të shënojë rritje të lartë vjetore në bazë neto dhe bruto në tremujorin e dytë të vitit 2024, por me një ritëm më të ngadaltë krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Kështu, rritja nominale vjetore e pagës mesatare neto dhe bruto arrin përkatësisht në 13.9% dhe 14.1% (në tremujorin paraardhës rritje përkatësisht 16.3% dhe 16.6%). Rritja vjetore e pagave në këtë tremujor e reflekton në masë të madhe edhe efektin transferues të rritjes së pagave të punonjësve të sektorit²² publik në shtator të vitit 2023 në përputhje me marrëveshjen e re kolektive dhe pjesërisht është rezultat i rritjes së pagës minimale bruto prej 12.15 % në mars të vitit 2024 dhe rrjedhimisht edhe rritja lineare e pagave në administratën shtetërore.²³

Në rritjen e pagave kontribuon edhe vazhdimësia e disa faktorëve strukturorë, si mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës, e cila pjesërisht reflektohet në nivelet e vendeve të lira të punës në veprimtari të caktuara. Analizuar sipas veprimtarisë, rritje e pagave vjetore është vërejtur në të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe veçanërisht në veprimtaritë: "arsim", "administratë publike dhe mbrojtje", "art, argëtim dhe rekreacion", "bujqësi, pylltari dhe peshkim",

²² Në korrik të vitit 2023, qeveria nënshkroi marrëveshje të re kolektive për sektorin publik, e cila përfshin rritje pagash prej 10% nga shtatori i vitit 2023, rritje shtesë të pagave në shtator të vitit 2024, nëse norma vjetore e inflacionit në gjashtë muajt e parë të vitit 2024 kalon 3% (paga bazë bruto rritet në përqindje për diferencën deri në 3%) dhe rishikim të metodologjisë për përcaktimin e pagave nga marsi i vitit 2025 që lidh pagën bazë bruto me pagën mesatare bruto në nivel shtetëror me rritje të koeficientit të kompleksitetit prej të paktën 5%. Gjithashtu, raporti i kompleksitetit të punës do të përputhet me rritjen nominale të PBB-së, nëse është më i ulët se rritja mesatare e pagës bruto.

²³ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fudit ligjore për rritjen e pagës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 68/24) nga marsi i vitit 2024, paga minimale neto është rritur për 2.392 denarë. Lartësia e pagës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi i vitit 2024 deri në shkurt të vitit 2025, është 33.352 denarë (paraprakisht 29.739 denarë), ndërsa në shumën neto 22.567 denarë (paraprakisht 20.175 denarë). Kjo rritje është llogaritur në përputhje me metodologjinë e marsit të vitit 2022, e cila e përaftron pagën minimale me rritjen e pagës mesatare të paguar në vend dhe me indeksin e shpenzimeve të jetesës në vitin paraardhës, dhe kjo përkatësisht me 50% të rritjes së secilit tregues. Gjithashtu, është përcaktuar se paga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e lartësisë së pagës mesatare neto të paguar në RMV për vitin e kaluar.

"furnizim me uji", "industri përpunimi" dhe "kujdes shëndetësor dhe social". Në kushte të rritjes së çmimeve të konsumit prej 3.9%, **pagat reale neto dhe bruto në tremujorin e dytë shënuan rritje përkatësisht prej 9.6% dhe 9.8% në bazë vjetore, që përfaqëson ngadalësim në krahasim me rritjen e tremujorit paraardhës**. Në korrik të vitit 2024, rritja vjetore e pagës mesatare nominale neto u ngadalësua dhe është 12.9%, ndërkohë që rritja e pagës reale neto mbeti e njëjtë me atë të tremujorit të dytë.



1.5. Inflacioni


Në tremujorin e tretë të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohej dhe u reduktua në 2.6% (3.9% në tremujorin e mëparshëm). Arritjet e tilla e reflektojnë rritjen më të ngadaltë të çmimeve të ushqimeve dhe rënien e çmimeve të lëndëve djegëse, me një përshpejtim të moderuar të inflacionit bazë. Nga aspekti i kategorive të veçanta, rritja e ngadaltë e komponentit ushqimor vjen më së shumti si pasojë e rënies së çmimeve në kategoritë "perime", "fruta" dhe "bukë dhe drithëra", ndërsa rënia e çmimeve të energjisë kryesisht vjen për shkak të uljes së çmimeve të derivateve të naftës. Gjithashtu, në shtator u miratuan sërish disa masa për kufizimin e marzhave të fitimit për disa produkte ushqimore bazë dhe hyri në fuqi Ligji për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare. Lidhur me faktorët që do të ndikojnë në dinamikën e ardhshme afatshkurtër të çmimeve të konsumit, në tremujorin e tretë, çmimet e prodhuesve vendas të produkteve industriale shënuan rritje të përshpejtuar, ndërkohë që inflacioni i importuar vijoi të ngadalësohej. Sa i përket pritjeve për normën e inflacionit në periudhën e ardhshme, sipas Anketës së Bankës Popullore, analistët ekonomik presin ngadalësim të mëtejshëm të saj, ngjashëm me dinamikën e parashikuar të inflacionit të Bankës Popullore dhe institucioneve ndërkombëtare.

1.5.1. Inflacioni aktual

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit u ngadalësua më tej në 2.6%²⁴, e cila vjen kryesisht si pasojë e rritjes së ngadaltë të çmimeve të ushqimeve, si dhe rënies së çmimeve të lëndëve djegëse. Veç kësaj, në raport me masat e Qeverisë të lidhura me çmimet, në

²⁴ Në bazë tremujore, çmimet e konsumit të brendshëm janë më të larta me 1.3% dhe në bazë të përshtatjes sezonale me 0.6%.

shtator u miratua Vendimi për kufizimin e marzhës për mjetet shkollorë²⁵ dhe Vendimi për kufizimin e marzhës bruto të fitimit për një pjesë të produkteve ushqimore bazë²⁶, dhe hyri në fuqi edhe Ligji për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare²⁷.



Rritja vjetore e çmimeve të ushqimeve në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi një ngadalësim më të madh dhe mesatarisht është 0.5% (3.5% në tremujorin paraardhës). Kjo lëvizje rënëse e çmimeve të ushqimeve vjen më së shumti si pasojë e rënies së çmimeve në kategoritë "perime", "fruta" dhe "bukë dhe drithëra", të cilat në tremujorin paraardhës shënuan rritje vjetore dhe pjesërisht është rezultat i faktorëve sezonal (zhvendosja e sezonit). Gjithashtu në shtator u miratua edhe masa për kufizimin e marzhës bruto të fitimit të disa prej produkteve ushqimore bazë në 10% si në tregtinë me shumicë ashtu edhe në atë me pakicë²⁸, kurse nga fundi i shtatorit filloi të zbatohet Ligji për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare, i cili pritet të ketë një ndikim shtesë në uljen e çmimeve në periudhën e ardhshme. Nga aspekti i faktorëve për lëvizjen e ardhshme të inflacionit, gjatë kësaj periudhe, çmimet botërore të produkteve ushqimore bazë shënuan rënie të mëtejshme. Nga ana tjetër, pas pesë tremujorësh rënieje konstante, çmimet e shitjes së prodhuesve vendas të ushqimeve shënuan rritje gjatë kësaj periudhe, por rritje shënuan edhe çmimet e huaja efektive të ushqimeve të shprehura në euro²⁹.

²⁵ Sipas Vendimit të qeverisë të datës 3 shtator të vitit 2024, marzha e fitimit të mjeteve shkollorë me shumicë do të kufizohet në 5%, ndërsa me pakicë në 10%. Ky vendim do të zbatohet deri më datë 20.10.2024 ([lidhje](#)).

²⁶ Sipas Vendimit të qeverisë, marzhi bruto i fitimit të disa prej produkteve ushqimore bazë kufizohet në 10% si në tregtinë me shumicë ashtu edhe në atë me pakicë. Në listën e produkteve ushqimore bazë në të ashtuquajturën shportë vjeshtore përfshihen 73 produkte që janë më të përfaqësuara në shportën e konsumit të qytetarëve. Ai do të zbatohet deri më 31 tetor të vitit 2024 ([lidhje](#)).

²⁷ Përputhshmëria me dispozitat e Ligjit për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore duhet të zgjasë deri më datën 27.09.2024, ku ndër të tjera parashikohet që lartësia e të gjitha tarifave të ngarkuara nga furnizuesi ndaj blerësit në zinxhirin e furnizimit në total nuk duhet të jetë më i lartë se 10% e xhiros së realizuar në vitin aktual.

²⁸ Për më shumë detaje rreth listës së produkteve, shihni në vijim në [lidhje](#).


²⁹ Të dhënat për çmimet e shitjeve të prodhuesve vendas të ushqimeve dhe çmimet e huaja efektive të ushqimeve u referohen dy muajve të parë të tremujorit të tretë të vitit 2024.



	Ndryshime vjetore, në %								Kontributet në ndryshimet vjetore, në p.p.							
	2023					2024			2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2023	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2023	Tr.1	Tr.2	Tr.3
Indeksi i çmimeve të konsumit – gjithsej	16.1	11.2	7.7	3.4	9.4	3.4	3.9	2.6	16.1	11.2	7.7	3.4	9.4	3.4	3.9	2.6
Ushqime	24.6	14.5	10.2	0.8	11.8	2.4	3.5	0.5	8.6	5.3	3.8	0.3	4.3	0.9	1.3	0.2
Çmime të energjisë	15.3	9.2	3.7	2.2	7.3	0.5	1.8	-2.4	2.0	1.2	0.5	0.3	1.0	0.1	0.2	-0.3
Energji elektrike	14.0	14.0	8.1	8.1	10.9	2.7	2.7	-0.9	1.0	1.0	0.6	0.6	0.8	0.2	0.2	-0.1
Ngrohje qendrore	14.2	14.2	4.3	2.3	8.4	3.5	3.5	1.5	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Lëndë djegëse të lëngshme dhe lubrifikantë	4.2	-14.3	-13.3	-8.6	-8.5	-2.4	3.9	-5.6	0.1	-0.5	-0.5	-0.3	-0.3	-0.1	0.1	-0.2
Ushqim dhe energji (çmime të paqëndrueshme)	22.2	13.2	8.5	1.1	10.7	1.9	3.1	-0.2	10.7	6.5	4.3	0.6	5.3	1.0	1.5	-0.1
Inflacioni bazë i llogaritur nga BPRMV (indeksi total-ushqim dhe energji (kategoritë 01.1, 04.5, 07.2.2))	10.2	9.1	7.0	5.9	8.0	5.0	4.8	5.5	5.3	4.6	3.5	2.9	4.0	2.4	2.4	2.7
Indeksi total pa i përfshirë energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët, ushqimet e papërpunuara (ESHS)	15.8	11.2	7.2	3.7	9.3	3.3	4.6	4.3								
Indeksi total pa i përfshirë energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët, ushqimet e papërpunuara, duhanin dhe pijet alkoolike (ESHS)	16.6	11.4	7.2	3.4	9.4	2.7	4.5	4.2								

Burimi: Enti Shtetëror për statistikë dhe llogaritje të BPRMV-së

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, çmimet e energjisë shënuan rënie prej 2.4% në bazë vjetore, kundrejt rritjes në tremujorin paraardhës, e cila erdhi më së shumti si pasojë e rënies së çmimeve të derivateve të naftës, në përputhje me lëvizjet në bursat botërore. Kontribut negativ kanë edhe çmimet e energjisë³⁰ elektrike për shkak të efektit bazë që lidhet me rritjen e çmimeve në tremujorin e tretë të vitit të kaluar dhe me nivelin më të ulët të çmimeve në tremujorin aktual (duke e marrë parasysh uljen e çmimeve në janar të këtij viti). Gjithashtu, çmimet e ngrohjes qendrore³¹ janë ulur nga gushti, gjë që ka ndikuar në uljen e rritjes mesatare të tyre në këtë tremujor.



Inflacioni bazë në tremujorin e tretë të vitit 2024 u përshpejtua në mënyrë të moderuar, pas ngadalësimit të vazhdueshëm në pesë tremujorët e fundit, dhe arriti në 5.5% në bazë vjetore (4.8% në tremujorin e mëparshëm), që është kryesisht refleks i rritjes më të fuqishme të çmimeve të shërbimeve në restorante dhe hotele, para së gjithash në çmimet e shërbimeve të akomodimit. Kështu, këto çmime vazhdojnë të kenë kontribut më të madh në rritjen e inflacionit bazë, ndërsa kontribut më të rëndësishëm kanë edhe çmimet e produkteve të higjienës personale, të duhanit³² dhe të kategorisë "mobilitet, orë dhe mirëmbajtje e orëve". Në raport me pjesën tjetër të nën indekseve të inflacionit, të cilët i përjashtojnë çmimet më të ndryshueshme, ata shënuan një ngadalësim


³⁰ Sipas propozim-vendimit të përgatitur për përcaktimin e çmimeve të shitjes nga Furnizuesi Universal, i konfirmuar nga KRRE-ja për aplikimin e duhur të sistemit tarifor, nga 1 korriku i vitit 2024, kanë filluar të aplikohen çmimet e reja të energjisë elektrike për konsumatorët e vegjël/amvisëritë. (lidhje). Sipas të njëjtit, për 88% të amvisërive që janë në bllokun e parë dhe të dytë, çmimi i energjisë elektrike ka një korrigjim prej 0.4%. Për ata konsumatorë që janë në bllokun e tretë, që është rreth tetë për qind e amvisërive, çmimi rritet me 0,48 për qind dhe për bllokun e katërt çmimi rritet me 0,57 për qind. (lidhje).

³¹ Komisioni Rregullator i Energjetikës (KRRE) ka marrë vendim sipas të cilit, nga gushti, çmimet e energjisë termike për amvisëritë do të jenë më të ulëta për 3,16%. (lidhje).

³² Në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin për akciza, akciza e cigareve është rritur për 0,23 denarë për copë, në zbatim nga janari i vitit 2024. Sa i përket produkteve të tjera të duhanit, ndryshimet mund të shihen në lidhje. Në të njëjtën kohë, çdo vit deri në vitin 2030 parashikohet rritje e akcizës.

të lehtë të rritjes në këtë tremujor. Kështu, në indeksin total pa energjinë³³, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët (për transport) dhe ushqimet e papërpunuara, rritja vjetore është 4.3% (4.6 në tremujorin paraardhës), ndërsa rritja e indeksit total pa energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët (për transportin), ushqimet e papërpunuara, duhani dhe pijet alkoolike u ul në 4.2% (4.5% në tremujorin paraardhës).

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, **çmimet e prodhimit të produkteve industriale** shënuan rritje vjetore prej 3.8%,³⁴ që përfaqëson përshpejtim krahasuar me rritjen në tremujorin paraardhës (1.2%). Në të njëjtën kohë, rritja e çmimeve të mallrave të konsumit edhe këtë tremujor, ka kontribut më të madh në rritjen e përgjithshme të çmimeve të prodhimit, ndërsa kontribut pozitiv kanë pasur edhe çmimet e energjisë. Nga aspekti i veprimtarive të veçanta, rritja në pjesën më të madhe rezulton nga rritja e çmimeve të lëndëve djegëse, çmimeve të ushqimeve dhe pijeve. Kështu, **çmimet e prodhimit të energjisë dhe produkteve të konsumit të gjerë**, si një kategori e përmblodhur dhe si një nga faktorët që ndikojnë në dinamikën e çmimeve të konsumit, shënuan rritje prej 7.6%, që paraqet një përshpejtim krahasuar me rritjen e tremujorit paraardhës (4.7%). Nga ana tjetër, **inflacioni**³⁵ i huaj **efektiv**, si indikator tregues i inflacionit të importuar, edhe në tremujorin e tretë, ka shënuar rritje të ngadaltë, duke arritur në 2.8% (3.2% në tremujorin paraardhës).



Në tremujorin e tretë të vitit 2024, vërehet **ngadalësim i rritjes së çmimeve të banesave** të matura nëpërmjet indeksit hedonik³⁶, të cilat janë më të larta me 8,0% në bazë vjetore (11,5% në tremujorin paraardhës). Nga aspekti i ofertës, pas pesë tremujorësh rënie të vazhdueshme, në tremujorin e dytë të vitit 2024, vlera e ndërtesave të ndërtuara për banim shënoi një rritje prej 10.4% në bazë vjetore. Të dhënat e disponueshme për vlerën e miratimeve të dhëna për ndërtimin e ndërtesave për banim për tremujorin e tretë të vitit 2024³⁷, tani për tani tregojnë për rritje të mëtejshme të lartë vjetore, në kushtet e bazës së ulët krahasuese. Nga aspekti i kërkesës për banesa, vihet re një përshpejtim i lehtë i rritjes vjetore të kredive për banesa në këtë periudhë³⁸.

³³ Kategoria "energji" i referohet energjisë elektrike, gazit, lëndëve djegëse të lëngshme dhe të ngurta për ngrohje dhe ngrohjes qendrore.



³⁴ Analiza e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale i referohet dy muajve të parë të tremujorit të tretë të vitit 2024.

³⁵ Përlogaritja e inflacionit të jashtëm efektiv është nxjerrë nga shuma e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të mallrave të konsumit. Struktura e ponderimit bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili prej vendeve në totalin e importit nominal në periudhën 2016 - 2018. Në përlogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Polonia dhe Spanja. Të dhënat u referohen dy muajve të parë të tremujorit të tretë të vitit 2024.

³⁶ Indeksi hedonik i çmimeve të banesave, i përgatitur nga BPRMV-ja mbi bazën e shpalljeve për shitje në kryeqytet dhe i publikuar nga agjencitë që merren me transaksionet e pasurive të paluajtshme. Çmimi i banesës është funksion i sipërfaqes, lagjes në të cilën ndodhet, katit, nëse banesa ka ngrohje qendrore dhe nëse apartamenti është i ri.

³⁷ Analiza i referohet muajit të parë të tremujorit të tretë të vitit 2024.

³⁸ Të dhëna të disponueshme për dy muajt e parë të tremujorit të tretë të vitit 2024.



1.5.2. Pritshmëritë për inflacionin

Për sa i përket ecurisë së pritshme të normës së inflacionit, institucionet vendase dhe ato ndërkombëtare parashikojnë një prirje rënëse të rritjes së çmimeve të konsumit në periudhën në vijim. Të ngjashme janë edhe pritshmëritë e analistëve ekonomikë të anketuar, të shprehura në **Anketën për pritshmëritë për inflacion dhe pritshmëritë për lëvizjen e PBB-së reale**³⁹, të realizuar në shtator të vitit 2024, sipas së cilës ata parashikojnë ulje të normës së inflacionit në nivelin 3.6% në vitin 2024, 2.9% në vitin 2025 dhe 2.4% në vitin 2026, në përputhje me pritjet për presione më të moderuara të çmimeve për shkak të stabilizimit gradual të çmimeve të ushqimeve dhe lëndëve djegëse, masave që merren nga hartuesit e politikave, si dhe ngadalësimit të inflacionit të jashtëm.

Projeksionet dhe pritshmëritë për normën e inflacionit

	2024	2025	2026
Analistët ekonomikë	3.6	2.9	2.4
FMN	3.3	2.3	2.0
Konsensusi forkast	3.6	2.7	
Ministria e Financave	3.5	2.2	2.0
BPRMV	3.5	2.5	2.0

Burimi: Anketa mbi pritshmëritë për inflacionin dhe pritshmëritë mbi lëvizjen e PBB-së reale, shtator 2024; FMN, Pasqyrë Ekonomike Botërore, Tetor 2024; Konsensusi forkast, shtator 2024; Ministria e Financave, Strategjia Fiskale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 2025-2029, shtator 2024; dhe BPRMV, tetor 2024.



Presionet më të dobëta nga çmimet e ushqimeve dhe energjisë kanë një efekt të favorshëm në pritjet për lëvizjet e ardhshme afatshkurtra të çmimeve në segmentin e industrisë përpunuese, ndërtimtarisë dhe sektorit të shërbimeve. Kështu, brenda **sektorit të korporatave**⁴⁰, në tremujorin e tretë të vitit 2024, mesatarisht, pritjet për lëvizjet e çmimeve në tre muajt e ardhshëm janë pak më të favorshme në industrinë përpunuese, ndërtimtari dhe në sektorin e shërbimeve, ku ka një rënie të numrit të drejtuesve të ndërmarrjeve që presin rritje të çmimeve të produkteve të tyre. Nga ana tjetër, në tregtinë me pakicë vihet re një përkeqësim i lehtë i këtij raporti krahasuar me tremujorin paraardhës. Për sa i përket **pritjeve të konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm**⁴¹,

³⁹ Duke filluar nga tetori i vitit 2017, BPRMV-ja bëri ndryshim në anketimin e deritanishëm "Anketë për pritshmëritë e inflacionit". Hulumtimi i ri anketues "Anketë për pritshmëritë për inflacion dhe pritshmëritë për lëvizjen e PBB-së reale" është kryer mbi një kampion analistësh ekonomikë, dhe subjekti i anketës është zgjeruar, në përputhje me praktikën e Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Rezultatet e Anketës mund të gjenden në [lidhje](#).

⁴⁰ Anketa mbi tendencat e biznesit të Komisionit Evropian në industri, tregti me pakicë, ndërtimtari dhe në sektorin e shërbimeve që nga shtatori i vitit 2024.

⁴¹ Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve që nga shtatori i vitit 2024.

vërehet përkeqësim i lehtë në krahasim me pritjet e mëparshme, pra është në rënie numri i njerëzve që presin ulje të çmimeve në 12 muajt e ardhshëm, në krahasim me ata që presin rritje të çmimeve.





1.6. Bilanci i pagesave

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 0.8% të PBB-së, dhe shënon përmirësim të lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Faktori kryesor për ecuri më të mirë është suficiti më i lartë te shërbimet, duke e marrë parasysh bazën krahasuese nga viti i kaluar, kur u regjistruan dalje neto më të larta në shërbimet e ndërtimit për shkak të pagesave për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d. Nga ana tjetër, në drejtim të kundërt kanë vepruar edhe rritja e deficitit tregtar, si pasojë e rënies së komponentit të eksportit, si dhe suficiti më i ulët tek të ardhurat dytësore. Në llogarinë financiare, gjatë tremujorit të dytë flukset hyrëse janë realizuar në bazë neto, si rezultat i flukseve hyrëse neto në investime të drejtpërdrejta dhe te huamarrjet. Rezervat valutore mbeten ende në zonën e sigurt.

	2023					2024		2023					2024	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1	Tr.2	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1	Tr.2
	Në milionë euro					% e PBB-së								
I. Llogaria rrjedhëse	78,6	-126,7	229,1	-125,4	55,6	-195,1	-111,7	0,6	-0,9	1,7	-0,9	0,4	-1,3	-0,8
Mallra dhe shërbime, neto	-366,2	-581,9	-341,1	-609,3	-1898,6	-516,8	-501,9	-2,7	-4,3	-2,5	-4,5	-13,9	-3,6	-3,5
Eksport	2414,4	2483,2	2478,9	2510,4	9886,8	2286,2	2404,6	17,7	18,2	18,2	18,4	72,4	15,8	16,6
Import	2780,6	3065,1	2820,0	3119,7	11785,4	2802,9	2906,5	20,4	22,4	20,7	22,8	86,3	19,4	20,1
Mallra, neto	-620,5	-596,4	-634,0	-783,2	-2634,1	-816,9	-743,7	-4,5	-4,4	-4,6	-5,7	-19,3	-5,6	-5,1
Shërbime, neto	254,3	14,5	292,9	173,9	735,5	300,1	241,8	1,9	0,1	2,1	1,3	5,4	2,1	1,7
Të ardhura primare, neto	-183,0	-184,4	-189,6	-185,4	-742,4	-196,7	-194,4	-1,3	-1,4	-1,4	-1,4	-5,4	-1,4	-1,3
Të ardhura dytësore, neto	627,8	639,7	759,8	669,4	2696,6	518,3	584,7	4,6	4,7	5,6	4,9	19,7	3,6	4,0
II. Llogaria e kapitalit	0,2	-0,5	-0,5	-0,1	-0,9	0,0	0,5	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Kredi neto (+)/huamarrje neto (-) (zëri përmblendës i llogarisë rrjedhëse dhe asaj kapitale)	78,8	-127,2	228,5	-125,5	54,7	-195,1	-111,1	0,6	-0,9	1,7	-0,9	0,4	-1,3	-0,8
III. Llogaria financiare	-191,1	-172,1	565,2	-709,2	-507,2	115,7	-71,2	-1,4	-1,3	4,1	-5,2	-3,7	0,8	-0,5
Investimet e drejtpërdrejta	-129,5	-119,7	-40,1	-198,8	-488,1	-251,6	-204,4	-0,9	-0,9	-0,3	-1,5	-3,6	-1,7	-1,4
Investimet e portfolios	-438,5	20,0	414,9	37,6	34,0	67,0	47,3	-3,2	0,1	3,0	0,3	0,2	0,5	0,3
Valutat dhe depozitat	124,0	120,1	268,1	-99,5	412,7	174,5	89,7	0,9	0,9	2,0	-0,7	3,0	1,2	0,6
Huazimet	163,7	-174,2	-8,1	-384,9	-403,5	23,1	-47,7	1,2	-1,3	-0,1	-2,8	-3,0	0,2	-0,3
Kredi dhe paradhënie tregtare	84,9	-17,7	-69,8	-63,6	-66,2	102,9	44,0	0,6	-0,1	-0,5	-0,5	-0,5	0,7	0,3
Llogari të tjera për arkëtim/pagesë	5,0	0,1	0,1	0,1	5,2	-0,3	0,4	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
IV. Të drejtat e veçanta të tërheqjes (krijimi neto i detyrimeve)	0,2	0,2	0,1	0,1	0,7	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
V. Gabimet dhe lëshimet neto	-3,2	7,3	27,9	9,0	41,1	18,9	55,3	0,0	0,1	0,2	0,1	0,3	0,1	0,4
VI. Rezervat valutore	266,7	52,3	-308,7	592,8	603,1	-291,9	15,4	2,0	0,4	-2,3	4,3	4,4	-2,0	0,1



Burimi: BPRMV.

1.6.1. Llogaria rrjedhëse

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi deficit në vlerën 111.7 milionë euro, ose 0.8% e PBB-së⁴². Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u arrit përmirësim i lehtë prej 0.2 p.p. i PBB-së, i cila vjen kryesisht nga suficiti më i lartë te shërbimet. Gjegjësisht, arritjet më të mira në shërbime në këtë periudhë janë kryesisht rezultat i suficitit të arritur te shërbimet e ndërtimit, për dallim nga deficitit i lartë i vitit të kaluar, kur u realizuan pagesat për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d. Kontribut shtesë për arritjet më të mira është reduktimi i deficitit te shërbimet për shfrytëzimin e pronësisë intelektuale, si dhe suficiti më i lartë te shërbimet e telekomunikacionit, ato kompjuterike dhe të informacionit, të cilat e përfaqësojnë kategorinë e


⁴² Për llogaritje përdoret shuma e projektuar e PBB-së nominale (tetor 2024).

shërbimeve me pjesëmarrjen më të madhe strukturore në rritje. Nga ana tjetër, deficitit tregtar ka shënuar zgjerim, kryesisht si pasojë e rënies së komponentit të eksportit, me një rritje të vogël të importit. Rënia e eksportit vjen më së shumti nga reduktimi i eksportit të një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj që lidhen me industrinë e automobilave, si dhe nga reduktimi i eksportit të automjeteve dhe hekurit e çelikut. Këto arritje kanë çuar në zgjerimin e deficitit jo energjetik, më të madh se lëvizjet e favorshme në deficitin energjetik, ku deficitit është ngushtuar për shkak të uljes së çmimeve të importit dhe sasive të gazit, si dhe çmimeve disi më të ulëta të importit të energjisë elektrike. Në drejtim të rritjes së deficitit në llogarinë rrjedhëse vepron edhe suficiti i reduktuar në të ardhurat dytësore, në pjesën më të madhe si pasojë e uljes së transfertave private.



Shtojca 1: Shkëmbimi në tregtinë e jashtme të mallrave dhe lëvizja e kursit nominal dhe real efektiv të këmbimit (KNEK dhe KREK)⁴³

Shkëmbimi në tregtinë e jashtme në tremujorin e dytë të vitit 2024 arrin në 4,805.7 milionë euro, pra 33.2% e PBB-së, që krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë paraqet rënie prej 2% (ose 2.7 p.p. të PBB-së). Rënia vjetore në tërësi vjen nga eksporti i mallrave, në krahasim me rritjen e importit të mallrave gjatë kësaj periudhe.




Në tremujorin e dytë të vitit 2024, eksportet e mallrave shënuan rënie prej 5.9% në bazë vjetore. Kontributin kryesor në rënie e ka eksporti i një pjese të kapaciteteve prodhuese të industrisë automobilistike me pronësi të huaj, të lidhura me eksportin e produkteve kimike. Kontribut negativ në këtë periudhë shënoi edhe eksporti i automjeteve, ndërsa rezultate negative pati edhe sektori i përpunimit dhe nxjerrjes së metaleve, i cili është reflektuar në uljen e eksportit të hekurit dhe çelikut

⁴³ Sipas Metodologjisë së shkëmbimit në tregtinë e jashtme, të dhënat për eksportin e mallrave publikohen në bazë f.o.b, dhe për importin e mallrave në bazë - c.i.f.


dhe të xeherorëve metalik në këtë tremujor. Gjithashtu, vazhdon rënia e eksporteve të tekstileve dhe veshjeve. Nga ana tjetër, segmenti i mbetur i industrisë së automobilave e vazhdon ecurinë e qëndrueshme të eksporteve, gjë që ka kontribuar në rritjen e eksporteve të pajisjeve dhe makinerive. **Importet e mallrave në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënuan rritje të lehtë prej 1% në bazë vjetore**, në ndryshim nga tendenca rënëse në pesë tremujorët e fundit. Rritja e importit të automjeteve dhe rritja e importit të pajisjeve dhe makinerive dhe, në një masë më të vogël, dhe importi i hekurit e çelikut janë kategoritë që kontribuuan në këto arritje. Nga ana tjetër, importi i metaleve me ngjyra, si pjesë përbërëse e lëndës së parë të një pjese të objekteve të eksportit në pronësi të huaj, si dhe importi i produkteve kimike inorganike, shënuan rënie në bazë vjetore. Gjithashtu, ka shënuar rënie edhe importi i lëndëve djegëse, para së gjithash për shkak të importit më të ulët të gazit natyror, me import më të madh të derivateve të naftës dhe import të pandryshuar të energjisë elektrike. **Arritjet në të dy komponentët e shkëmbimit në tregtinë e jashtme në tremujorin e dytë të vitit 2024 çuan në zgjerim të deficitit tregtar me 23.4% në bazë vjetore**, në kushte të rritjes së deficitit në bilancin jo energjetik, duke e ulur njëkohësisht deficitin në bilancin energjetik.

Të dhënat më të fundit të disponueshme për periudhën korrik - gusht të vitit 2024 tregojnë për rritje më të ulët të komponentit të eksportit dhe rritje të mëtejshme të komponentit të importit në shkëmbimet në tregtinë e jashtme, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja vjetore e eksportit vjen kryesisht nga eksporti më i lartë i pajisjeve dhe makinerive, si dhe nga eksporti më i lartë i energjisë dhe duhanit. Nga ana tjetër, eksporti i lëndëve kimike ka shënuar rënie në bazë vjetore. Rritja në anën e importit në këtë periudhë është shkaktuar më së shumti nga rritja e importit të automjeteve, si dhe nga importi i pajisjeve, makinerive dhe ushqimeve, kundrejt rënies së importit të energjisë.



Sipas analizës së importit të mallrave nga aspekti i ndarjes sipas Sistemit të Llogarive Kombëtare (System of national accounts – SNA), vihet re import më i lartë i produkteve kapitale, si dhe i mallrave për konsum të gjerë, i kompensuar në masë të madhe nga importi më i ulët i produkteve të ndërmjetme. Rritja e importeve të destinuara për konsum⁴⁴ personal ngadalësohet në këtë tremujor në përputhje me rritjen më të ngadaltë të konsumit nga amvisëritë, ndërsa edhe më tej kontributin më të lartë e ka kryesisht importi i mallrave të konsumit që nuk përmenden diku tjetër, si dhe importi i ushqimeve dhe pijeve (të përpunuara), kryesisht për përdorim në amvisëri.


⁴⁴ Importi i mallrave për konsum personal analizohet si import i destinuar për konsum personal, i përafëruar me importin e mallrave të konsumit dhe importin e vlerësuar të automjeteve të pasagjerëve për përdorim individual.




Analiza e shkëmbimit në tregtinë e jashtme sipas partnerëve tregtarë tregon se në tremujorin e dytë të vitit 2024, Bashkimi Evropian është partneri më i rëndësishëm tregtar i ekonomisë vendase, me pjesëmarrje prej 61,2% në totalin e tregtisë së jashtme.


Analiza e anës së **eksportit** tregon se rënia në bazë vjetore vjen kryesisht nga eksporti në Gjermani, në kushtet e rënies së eksportit të produkteve të ndryshme të industrisë kimike. Kontribut shtesë në rënien ka dhe zvogëlimi i eksportit të automjeteve në Belgjikë dhe i hekurit e çelikut në Kinë. Në të njëjtën kohë, këto arritje u zbutën nga rritja e eksportit të pajisjeve elektrike në Republikën Çeke, si pjesë e eksportit të sektorit të automobilave. Nga aspekti i vendeve të veçanta në anën e **importit**, analiza tregon se kontributin më të madh në rritjen vjetore të importeve e ka importi më i lartë i pajisjeve dhe makinerive dhe i hekurit e çelikut nga Kina. Importi më i lartë i lëndëve djegëse nga Bullgaria, si dhe importi më i lartë i pajisjeve dhe makinerive nga Gjermania ka gjithashtu ndikim në rritjen e importit në këtë periudhë të vitit. Nga ana tjetër, ka rënë importi i energjisë nga Rusia, si dhe importi i metaleve të çmuara dhe produkteve kimike inorganike nga Britania e Madhe. Për sa i përket **balanceve** të shkëmbimit në tregtinë e jashtme sipas partnerëve të veçantë, deficitit tregtar më i lartë në bazë vjetore i detyrohet më së shumti suficitit më të ulët në shkëmbimin me Gjermaninë dhe në një masë më të vogël me Belgjikën, si dhe bilancit më të lartë negativ në shkëmbimin me Kinën.

Eksporti i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e dytë të vitit 2024
(pjesëmarrje, në %)





Importi i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e parë të vitit 2024
(pjesëmarrje, në %)





Nga aspekti i treguesve të konkurrencës së çmimeve, në tremujorin e dytë të vitit 2024, kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar sipas kostos së jetesës është mbivlerësuar me 1.2% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i deflatuar me shpenzimet e prodhuesve të produkteve industriale është mbivlerësuar me 1.9%. Të arriturat e tilla janë reflektim i mbivlerësimit të kursit nominal efektiv të denarit prej 3% në bazë vjetore, kryesisht si pasojë e zhvlerësimit të rublës ruse dhe lirës turke në raport me monedhën vendase. Nga ana tjetër, shpenzimet relative të jetesës shënuan rënie prej 1.7%, me ulje të njëkohshme të çmimeve relative të prodhuesve të produkteve industriale me 1% në bazë vjetore.




Sipas analizës së lëvizjeve të indekseve të KREK të llogaritura sipas ponderit në bazë të tregtisë së jashtme pa produkte parësore, KREK në bazë të shpenzimeve të jetesës ka shënuar mbivlerësim të vogël prej 0.5% në bazë vjetore, ndërsa KREK në bazë të çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale është mbivlerësuar me 2.6%. Kursi nominal efektiv i këmbimit është mbivlerësuar me 3%, si pasojë e zhvlerësimit të lirës turke në raport me monedhën vendase. Në të njëjtën kohë, shpenzimet relative të jetesës shënuan rënie prej 2.4%, ndërsa çmimet relative të prodhuesve të produkteve industriale shënuan rënie prej 0.3%, në bazë vjetore.

Për sa i përket treguesve të konkurrencës së çmimeve për periudhën korrik - gusht të vitit 2024, KREK i deflatuar me shpenzimet e jetesës shënoi zhvlerësim prej 1.8%, ndërsa KREK u deflatua me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale të mbivlerësuar me 1.6%. Në të njëjtën kohë, KNEK mbivlerësohet për 0.8%, që më së shumti vjen si pasojë e zhvlerësimit të lirës turke në raport me




denarin. Njëkohësisht, bazuar në përlogaritjen e ponderuar në shkëmbimin në tregtinë e jashtme pa produkte parësore, indeksi KREK i deflatuar me shpenzimet e jetesës shënoi zhvlerësim prej 1.5%, ndërsa KREK e deflatuar me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale u mbivlerësua me 3.4%. Në të njëjtën kohë, KNEK mbivlerësohet me 1.4%, që më së shumti vjen si pasojë e zhvlerësimit të lirës turke në raport me monedhën vendase.




1.6.2. Llogaria financiare

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, llogaria financiare në bilancin e pagesave regjistroi hyrje neto prej 71.2 milionë euro, ose 0.5% të PBB-së. Në të njëjtën kohë, këto realizime të llogarisë financiare janë kryesisht si rezultat i hyrjeve neto në investime të drejtpërdrejta, kryesisht si rezultat i hyrjeve neto të arritura në komponentin jo huamarrës, pra fitim i riinvestuar dhe kapital i pronarit, me hyrje të njëkohshme në bazën neto dhe në huamarrjen ndërmjet kompanive. Krahas kësaj, ky tremujor ka pasur flukse hyrëse neto edhe te huamarrjet. Nga ana tjetër, valutat dhe depozitat kanë regjistruar dalje neto në bazën neto, si rezultat i daljeve neto në sektorët e tjerë. Njëkohësisht, dalje neto janë regjistruar edhe te investimet e portfolios, për shkak të shlyerjes së interesit në bazë të euro bonove të emetuara më parë, si dhe te kreditë dhe paradhëniet tregtare.




Analiza në bazë vjetore tregon për ecuri më të dobët të flukseve financiare në tremujorin e dytë të vitit 2024, e cila vjen kryesisht si pasojë e uljes së flukseve hyrëse neto në kreditë afatshkurtra. Në të njëjtën kohë, te kreditë dhe paradhëniet tregtare janë regjistruar flukse dalje mbi bazë neto krahasuar me flukset hyrëse neto në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, në investimet e

drejtpërdrejta, flukse më të larta hyrëse u arritën në bazë neto, kryesisht si rezultat i flukseve hyrëse neto në huamarrjen ndërmjet kompanive, kundrejt daljeve të vogla neto në vitin e kaluar. Në të njëjtin drejtim, ndikuan edhe flukset dalje në kategorinë "valuta dhe depozita", kryesisht nën ndikimin e flukseve hyrëse neto të realizuara në sektorin bankar, kundrejt daljeve neto në të njëjtën periudhë të një viti më parë.




Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të dytë 2024 është 4,337.5 milionë euro, që paraqet një rritje prej 50.5 milionë euro krahasuar me tremujorin paraardhës. E analizuar nëpërmjet faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore rezulton më së shumti nga transaksionet e tjera, të lidhura me operacionet për administrimin e rezervave valutore.





Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të tretë 2024 është 4,406.6 milionë euro, që është një rritje prej 69.1 milionë euro krahasuar me tremujorin paraardhës. E analizuar përmes faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore rezulton nga ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor.

1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm bruto

Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare të ekonomisë maqedonase është negativ dhe arrin në 8,622,5 milionë euro, ose 59,5% të PBB-së. Krahasuar me situatën në fund të tremujorit paraardhës, pozicioni neto i borxhit shënoi zgjerim prej 1.3 p.p. të PBB-së, e cila vjen si pasojë e rritjes së detyrimeve ndërkombëtare (me 1.5 p.p. të PBB-së), me rritje të lehtë të njëkohshme të aktiveve ndërkombëtare (me 0.2 p.p. të PBB-së). Nga pikëpamja sektoriale, ndryshimi tremujor vjen nga rritja e detyrimeve neto në sektorët e tjerë (kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve në investimet e drejtpërdrejta).



Në bazë vjetore, vërehet një ngushtim i pozicionit negativ të investimeve ndërkombëtare me 0.5 p. p. të PBB-së⁴⁵, në kushte të fondeve më të larta ndërkombëtare, ndërkohë që detyrime ndërkombëtare janë pak më të larta (përkatësisht me 0.7 p.p. dhe 0.2 p.p. të PBB-së⁴⁶). Analiza sektoriale tregon se ky ndryshim vjen kryesisht si pasojë e ndryshimeve në pozicionin neto të shtetit (si pasojë e uljes së detyrimeve të bazuara në letrat me vlerë të borxhit). Efekt të kundërt patën detyrimet neto më të larta të sektorëve të tjerë.





Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, gjendja e borxhit të jashtëm bruto arrin në 11,875 milionë euro, ose 82% të PBB-së, që paraqet një rritje prej 0.5 p.p. të PBB-së, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Duke e përjashtuar efektin e aktiviteteve specifike për administrimin e rezervave devizore të Bankës Popullore⁴⁷, borxhi i jashtëm bruto arrin në 78.6% të PBB-së dhe shënon rritje tremujore prej 1.1 p.p. të PBB-së, në kushtet e rritjes së borxhit privat (me 1.2 p.p. të PBB-së) dhe nivelit pothuajse të pandryshuar të borxhit publik. Rritja e borxhit privat vjen si rezultat i rritjes së borxhit midis kompanive, si dhe i rritjes së detyrimeve afatshkurtra në bazë të kredive tregtare të sektorit jo bankar.



⁴⁵ Në vlera absolute, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë maqedonase në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 426,8 milionë euro.

⁴⁶ Në vlera absolute, në tremujorin e dytë të vitit 2024, fondet ndërkombëtare shënuan rritje vjetore prej 604.7 milionë euro, ndërsa detyrimet ndërkombëtare shënuan rritje vjetore prej 1,031.5 milionë euro.

⁴⁷ Veprimtaritë specifike për administrimin e rezervave valutore të bankës qendrore kanë të bëjnë me marrëveshjet-repo dhe operacione të tjera që lidhen me administrimin e rezervave valutore.



Borxhi i jashtëm bruto në fund të tremujorit të dytë shënoi rënie vjetore prej 2 p.p. të PBB-së⁴⁸, në kushtet e një rënie më të madhe të borxhit publik se rënia e borxhit privat (përkatësisht me 1.6 p.p. dhe 0.3 p.p. të PBB-së⁴⁹). Ndryshimi i borxhit publik vjen si pasojë e uljes së detyrimeve të qeverisë qendrore në bazë të letrave me vlerë të borxhit. Rënia vjetore e borxhit privat është reflektim i uljes së borxhit afatshkurtër ndaj bankave mbi bazën e valutave dhe depozitave, si dhe të borxhit më të ulët midis kompanive të subjektet e lidhura me kapitalin, ndërsa në drejtim të kundërt kanë vepruar detyrimet më të larta të sektorit jo bankar bazuar në operacionet tregtare, më konkretisht kreditë tregtare.



Më 30.06.2024, borxhi i jashtëm neto arrin në 4,239.1 milionë euro, ose 29.3% e PBB-së, që përfaqëson rritje tremujore prej 0.6 p.p. të PBB-së, nxitur nga rritja e borxhit-neto privat (me 0.8 p.p. të PBB-së), me rënie të njëkohshme të borxhit-neto publik (me 0.2 p.p. të PBB-së).

Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së vendit janë në zonën e sigurt. Përveç treguesit për pjesëmarrjen e borxhit të jashtëm bruto në PBB, i cili vazhdon të jetë në zonën e borxhit të lartë, të gjithë treguesit e tjerë të aftësisë për pagim dhe likuiditetit tregojnë për borxh të ulët të ekonomisë së vendit. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë strukturore në borxhin e jashtëm bruto të detyrimeve të bazuara në investimet e drejtpërdrejta, si formë e financimit të shoqërive me kapital të huaj, si dhe të detyrimeve kreditore tregtare që janë instrument financimi në tregtinë ndërkombëtare, e zbut profilin e rrezikut në lidhje me pozicionin e borxhit të ekonomisë. Gjegjësisht, niveli i borxhit të jashtëm bruto pa kredi tregtare dhe borxhi ndërmjet kompanive është më i ulët dhe arrin në 47% të PBB-së⁵⁰, që është tregues i borxhit të moderuar.

⁴⁸ Në vlera absolute, borxhi i jashtëm bruto i ekonomisë maqedonase në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 381,8 milionë euro.

⁴⁹ Në vlera absolute, borxhi i jashtëm publik dhe ai privat në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënuan rritje vjetore përkatësisht 76.7 dhe 305 milionë euro.

⁵⁰ Bëhet fjalë për borxhin pa marrëveshje-repo.



Treguesit për borxhin e jashtëm	Aftësia paguese				Likuiditeti		
	Pagesat e interesit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Borxhi bruto/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Borxhi bruto/PBB	Servisimi i borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Rezervat devizore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat devizore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur**	Borxhi afatshkurtër/ Borxhi i përgjithshëm
	në %				pjesëmarrje	pjesëmarrje	në %
31.12.2010	3,22	140,4	59,7	13,9	1,49	0,99	27,9
31.12.2011	3,12	148,4	64,6	16,8	1,78	1,18	25,2
31.12.2012	2,92	142,1	67,6	13,1	1,64	1,03	26,7
31.12.2013	2,51	137,3	67,3	15,8	1,64	1,08	23,3
31.12.2014	3,01	149,1	74,0	17,2	1,82	1,13	22,3
31.12.2015	2,69	143,9	73,2	20,0	1,69	1,13	21,3
31.12.2016	2,37	149,39	79,33	14,89	1,65	1,16	21,93
31.03.2017	2,69	138,68	76,61	12,72	1,47	1,00	23,53
30.06.2017	2,69	140,69	77,72	12,72	1,33	0,88	24,19
30.09.2017	2,69	138,24	76,37	12,72	1,26	0,86	24,57
31.12.2017	2,69	139,17	76,88	12,72	1,32	0,89	23,94
31.03.2018	2,22	132,80	78,27	15,77	1,30	0,93	25,06
30.06.2018	2,22	135,55	79,89	15,77	1,27	0,96	25,61
30.09.2018	2,22	135,98	80,14	15,77	1,30	0,98	25,59
31.12.2018	2,22	131,37	77,42	15,77	1,42	1,04	25,75
31.03.2019	2,05	119,55	74,37	8,89	1,40	0,98	25,81
30.06.2019	2,05	121,51	75,59	8,89	1,37	0,97	26,39
30.09.2019	2,05	124,39	77,38	8,89	1,37	0,97	27,62
31.12.2019	2,05	123,15	76,61	8,89	1,56	1,02	25,52
31.03.2020	2,45	121,76	73,94	16,79	1,39	0,95	26,63
30.06.2020	2,45	121,76	73,94	16,79	1,39	0,95	26,63
30.09.2020	1,91	129,93	80,75	13,61	1,72	0,98	22,93
31.12.2020	1,91	122,30	77,94	13,61	1,93	1,11	20,38
31.03.2021	2,19	127,34	83,90	16,27	1,93	1,18	21,49
30.06.2021	2,19	129,98	85,63	16,27	1,89	1,18	22,03
30.09.2021	2,19	125,62	82,76	16,27	1,77	1,30	22,21
31.12.2021	2,19	126,62	83,42	16,27	1,79	1,29	21,50
31.03.2022	1,77	118,01	83,09	9,38	1,27	0,95	25,97
30.06.2022	1,77	117,30	82,59	9,38	1,20	0,89	26,32
30.09.2022	1,77	123,64	87,06	9,38	1,35	0,90	26,89
31.12.2022	1,77	123,39	86,88	9,38	1,51	0,97	24,73
31.03.2023	2,39	112,58	84,25	14,79	1,63	1,01	23,57
30.06.2023	2,39	114,55	85,72	14,79	1,60	0,98	23,78
30.09.2023	2,39	110,61	82,78	14,79	1,51	1,02	24,37
31.12.2023	2,39	114,36	85,58	14,79	1,82	1,19	22,67
31.03.2024	2,89	106,69	81,79	12,80	1,65	0,97	23,18
30.06.2024	2,89	108,26	82,99	12,80	1,59	0,98	23,91
Kriteri i moderuar i borxhit*	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1,00		



II. Politika monetare⁵¹

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, Banka Popullore filloi një lirim të kujdesshëm gradual të pozicionimit të politikës monetare në përputhje me kushtet në ekonomi, duke e ulur me 0.25 p.p. normën bazë të interesit në shtator, deri në nivelin 6.05%. Normat e interesit për instrumentet e tjera monetare kanë mbetur të pandryshuara. Sa i përket instrumenteve makroprudenciale, Banka Popullore ka marrë vendim që në tremujorin e katërt të vitit 2025 ta mbajë normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 1,75%. Me ndryshime të tilla, ruhet kujdesi në politikën monetare dhe pritet që niveli i normave të interesit, së bashku me ndryshimet e mëparshme në rezervën e detyrueshme dhe masat e ndërmarra makroprudenciale, të kontribuojnë në stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm dhe në ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, Banka Qendrore Evropiane e uli normën bazë të interesit për depozitat e disponueshme me një shtesë prej 0.25 p.p. Rezervat valutore u ruajtën në nivel të përshtatshëm dhe në zonën e sigurt, ndërsa baza e depozitave dhe huadhënia bankare regjistroi nivel të qëndrueshëm të rritjes vjetore. Megjithatë, kushtet për zhvillimin e politikës monetare janë ende të pasigurta. Banka Popullore do të vazhdojë t'i monitorojë me kujdes rreziqet në ekonominë vendase dhe atë botërore dhe, nëse është e nevojshme, do të veprojë duke i përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për ta ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe stabilitetin e çmimeve.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, Banka Popullore e uli normën bazë të interesit me 0.25 p.p. dhe e reduktoi atë në nivelin 6.05%. Normat e interesit për depozitat njëditore dhe



⁵¹ Informacione më të detajuara për masat e reja monetare mund të lexoni në faqen e internetit të Bankës Popullore: https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacii/03%202024%20Hronologija_na_promenite_vo_postavenosta_na_monetarnite_instrumenti_na_Narodnata%20banka.pdf

shtatë ditore kanë mbetur të pandryshuara, përkatësisht në nivelin 4.2% dhe 4.25%. Shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e pandryshuar në 10.000 milionë denarë dhe vazhdoi zbatimi i ndryshimeve të mëparshme në instrumentin e rezervës së detyrueshme. Me ndryshime të tilla ruhet matura në politikën monetare, duke i marrë parasysh rreziqet që lidhen me mjedisin e jashtëm që ende ekzistojnë, por edhe me faktorët e brendshëm që ndikojnë në kërkesën totale. Pritet ende që niveli i normave të interesit, së bashku me ndryshimet e mëparshme në rezervën e detyrueshme dhe masat e ndërmarra makroprudenciale, të kontribuojnë në stabilitetin e çmimeve në periudhë afatmesme dhe në ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit. Në aspektin e instrumenteve makroprudenciale, Banka Popullore këtë tremujor ka marrë vendim që ta mbajë normën e shtresës mbrojtëse anticiklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 1,75%, e cila do të zbatohet në tremujorin e katërt të vitit 2025.



Arritjet⁵²e treguesve bazë makroekonomikë në ekonominë vendase janë brenda pritshmërive të Bankës Popullore. Rritja ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2024 u përshpejtua në 2.3% në bazë vjetore dhe është pothuajse identike me parashikimet e Bankës Popullore. Kështu, në gjysmën e parë të vitit u arrit rritje prej 1.8%, që është afër parashikimit të Bankës Popullore. Të dhënat me frekuencë të lartë për tremujorin e tretë të vitit 2024 janë të kufizuara. Në të vërtetë, të dhënat për muajin korrik tregojnë për rritje reale vjetore të qarkullimit në tregtinë e përgjithshme dhe në prodhimin industrial, për dallim nga rënia e tyre në tremujorin paraprak. Për sa i përket rreziqeve për rritjen në periudhën e ardhshme, ato ende ekzistojnë dhe lidhen mbi të gjitha me zhvillimet në mjedisin e jashtëm, por edhe me intensitetin e zbatimit të projekteve të infrastrukturës së brendshme. Norma vjetore e inflacionit u ngadalësua ndjeshëm në muajin gusht dhe arriti në 2.2%, me lëvizje të favorshme në të tre komponentët kryesorë, domethënë rënie të çmimeve të komponentët ushqimorë dhe energjetikë dhe rritje e ngadalë e inflacionit bazë. Gjendja në tregun valutor është e qëndrueshme, kurse lëvizjet janë të favorshme dhe kontribuojnë në ndërhyrjet me blerje neto të devizave nga Banka Popullore që nga fillimi i vitit. Niveli i rezervave valutore në fund të muajit gusht është i mjaftueshëm për ta ruajtur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të monedhës vendase. Në sektorin monetar, të dhënat e gushtit të vitit 2024 tregojnë se potenciali depozitues i bankave vazhdon të rritet, për momentin me arritje brenda pritshmërive për tremujorin e tretë. Arritjet në rritjen e kreditimit në muajin gusht janë gjithashtu të favorshme dhe rritja ruhet pak mbi nivelin e parashikuar.

⁵²I referohet informacionit të disponueshëm gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, i cili është marrë parasysh gjatë marrjes së vendimeve për pozicionimin monetar në atë periudhë.





Duke e marrë parasysh strategjinë monetare të aplikuar, gjatë marrjes së vendimeve monetare merret parasysh edhe pozicionimi i politikave të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), e cila gjatë tremujorit të tretë, për herë të dytë këtë vit, e uli normën bazë të interesit për depozitat e disponueshme me 0,25 p.p., në nivelin 3.5% në kushtet e ngadalësimit të inflacionit sipas pritshmërive. Në të njëjtën kohë, normën e interesit për operacionet bazë të rifinancimit e uli me 0.60 p.p.⁵³ dhe e reduktoi atë në nivelin 3.65%, në përputhje me ndryshimin e fundit të kuadrit operacional për drejtimin e politikës monetare nga marsi i vitit 2024. Kështu, diferenca ndërmjet normës bazë të interesit të Bankës Popullore dhe normës bazë të interesit të depozitave të disponueshme të BQE-së në shtator të vitit 2024 arriti në 2.55 p.p. dhe mbeti e njëjtë me tremujorin paraardhës. Për sa i përket normave treguese të interesit të tregut prej 1 m SKIBOR dhe 1 m EURIBOR, diferenca ndërmjet tyre u rrit me 0.2 p.p. në fund të shtatorit të vitit 2024, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Për sa i përket normave të interesit të depozitave në ekonominë vendase, në gusht të vitit 2024, normat e interesit për depozitat në denarë dhe në valutë mbetën të pandryshuara, krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa diferenca e interesit mbeti e pandryshuar dhe arriti në 0,9 p.p. Në rastin e totalit të depozitave të sapo pranuar,⁵⁴ diferenca e normës së interesit në gusht u ul në krahasim me fundin e tremujorit paraprak dhe arriti në 0,5 p.p., në kushte të rënies së normave të interesit në denarë (nga 2,9% në qershor në 2,6% në gusht) dhe rritje shumë të vogël të normave të interesit të devizës (nga 2,1% në qershor në 2,2% në gusht).


⁵³Normat e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit dhe për kreditë e disponueshme njëditore janë ulur me 0.60 p.p., në përputhje me ndryshimin më të fundit në kuadrin operacional për zhvillimin e politikës monetare të BQE-së nga data 13.3.2024, i cili ka hyrë në fuqi më datë 18.9.2024. Sipas kuadrit të ri, norma e interesit për depozitat e disponueshme do të përdoret si normë bazë e interesit për kryerjen e politikës monetare dhe niveli i dy normave të tjera të interesit do të përcaktohet nëpërmjet një difference të caktuar, në mënyrë që diferenca ndërmjet normës së interesit në operacionet bazë të rifinancimit dhe të depozitave të disponueshme ulet dhe do të arrijnë në 0.15 p.p., kurse diferenca ndërmjet normës së interesit për kreditë e disponueshme njëditore dhe për operacionet bazë të rifinancimit do të mbetet e njëjtë, pra 0.25 p.p. ([lidhje-interneti](#)).

⁵⁴ Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e reja të miratuara rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.




2.1. Likuiditeti i bankave

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, likuiditeti në denarë i bankave shënoi rritje, që në tërësi vjen si pasojë e ndryshimeve në instrumentet monetare, ndërsa faktorët autonome patën një kontribut shumë të vogël në tërheqjen e likuiditetit.



*ndryshim pozitiv: krijimi i likuiditetit, ndryshim negativ: tërheqja e likuiditetit.
Burimi: BPRMV.




*ndryshim pozitiv: krijimi i likuiditetit, ndryshim negativ: tërheqja e likuiditetit.
Burimi: BPRMV.

Nga aspekti i ndryshimit të instrumenteve monetare, investimet e bankave në depozita të disponueshme (njëditore dhe shtatë ditore) u zvogëluan për 11,910 milionë denarë në tremujorin e tretë të vitit 2024, gjë që kontribuoi në krijimin e likuiditetit në sistemin bankar. Në të njëjtën kohë, depozitat njëditore dhe 7 ditore janë ulur për 6,130, përkatësisht 5,780 milionë denarë. Gjendja e instrumentit bazë - bonot e thesarit të BPRMV-së nuk ka ndryshuar dhe në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 është 10.000 milionë denarë.



Faktorët autonom në bazë neto në tremujorin e tretë të vitit 2024 kontribuan në tërheqje shumë të vogël të likuiditetit nga sistemi bankar, për 275 milionë denarë. Ky ndryshim i faktorëve autonom vjen nga transaksionet e shtetit dhe të parave në qarkullim, ndërkohë që ndërhyrjet në valutë kanë kontribuar në rritjen e likuiditetit.



Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, bankat në llogaritë e tyre në Bankën Popullore vazhduan të kenë më shumë mjete të ndara se shuma e përcaktuar e rezervës së detyrueshme në denarë, mesatarisht për rreth 1,0%.


III. Lëvizjet në tregjet financiare

Norma e interesit në tregun e depozitave ndërbankare në tremujorin e tretë 2024 ishte 4.2%, me rritje të lehtë të aktivitetit në këtë treg. Kuotimet mesatare të SKIBOR-it shënuan lëvizje të lehtë në rënie. Në tregun primar të letrave shtetërore me vlerë, emetimet e reja ishin kryesisht me afate më të gjata, përderisa në tregun sekondar të letrave me vlerë tregtoheshin obligacionet shtetërore. Në Bursën e Maqedonisë, qarkullimi i aksioneve është rritur për 39,7% në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa vlera e MBI-10 ka shënuar rritje tremujore prej 13,9%. Në bursat rajonale, indekset shënuan rritje të ngadaltë, mesatarisht 2.9% në bazë tremujore. Nga këndvështrimi i tregjeve financiare ndërkombëtare, indekset e luhatshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, përkatësisht indekset MOVE dhe VIX, në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan ndryshim në rritje, gjë që tregon rritjen e pasigurisë dhe luhatshmërisë të tregjeve kryesisht të lidhura me frikën nga recesioni në SHBA, tensionet e intensifikuara gjeopolitike, zgjedhjet parlamentare në Francë dhe rrjedhën e fushatës parazgjedhore në SHBA. Pjesa më e madhe e diferencave ndërmjet yilde-ve të eurobonove maqedonase dhe gjermane shënuan zgjerim të lehtë në krahasim me tremujorin paraprak, me rënie më të fortë të yilde-ve të obligacioneve shtetërore gjermane, në raport me rënien e moderuar të eurobonove maqedonase.

3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasiguruara


Në tremujorin e tretë të vitit 2024, norma mesatare e interesit në tregun e depozitave ndërbankare (MBKS) ishte 4.2% dhe u rrit me 0.1 p.p. krahasuar me tremujorin paraardhës, ndërsa në tremujorin e dytë nuk ka pasur aktivitet në këtë treg. Tregtimi në tregun ndërbankar të depozitave në tremujorin e tretë të vitit 2024 arriti në 80 milionë denarë (nuk ka aktivitet në tremujorin paraardhës), tërësisht si rezultat i transaksioneve të lidhura brenda natës. Pothuajse të gjitha kuotimet mesatare të SKIBOR-it shënuan zhvendosje mjaft të vogël në rënie, e cila luhatej deri në 0.02 p.p. krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

MBKS, SKIBOR, MKDONIA dhe norma e interesit të bonove të thesarit në përqindje





Tregtimi me depozita

qarkullim, në milionë denarë



3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë


Gjendja e letrave shtetërore me vlerë të emetuara në tregun primar në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rritje për 7,085 milionë denarë ose 3,4% në bazë tremujore dhe arriti në 213,366 milionë denarë. Kështu, rritja tremujore është kryesisht te letrat me vlerë me afat më të gjatë maturimi, përkatësisht obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare dhe trevjeçare (me rritje përkatësisht prej 8,068 dhe 174 milionë denarë), ndërkohë ka rënie të gjendjes te obligacionet shtetërore dhjetëvjeçare dhe dymbëdhjetëmujore (rënie përkatësisht 1,138 dhe 19 milionë denarë). Analizuar nga aspekti i strukturës së letrave shtetërore me vlerë, obligacionet shtetërore edhe më tej janë kategoria dominuese, me pjesëmarrje prej 78.8%. Gjithashtu, obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e maturimit të letrave shtetërore me vlerë me 50.0% (47.8% në tremujorin paraardhës), që është në përputhje me udhëzimet e strategjisë fiskale të Ministrisë së Financave për emetimin e obligacioneve shtetërore me afat maturim më të gjatë, në mënyrë që të optimizohen pagesat e borxhit dhe të reduktohet rreziku i rifinancimit.⁵⁵ Për sa i përket strukturës valutore, letrat shtetërore me vlerë në monedhë vendase pa klauzolë valutore vazhduan të ruajnë pjesëmarrjen e tyre dominuese, duke përbërë 74.5% të totalit të letrave shtetërore me vlerë (73.0% në tremujorin paraardhës). Nga aspekti i strukturës së pronësisë, pjesa tjetër e investitorëve rriti lehtësisht pjesëmarrjen e tyre në këtë tremujor, nga 65.8% në 66.9%, për shkak të uljes së pjesëmarrjes së bankave (33.1%). Ndër investitorët e tjerë, fondet pensionale vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (me pjesëmarrje prej 47.5%).




Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024⁵⁶, normat e interesit për letrat shtetërore me vlerë të emetuara, të përcaktuara nga Ministria e Financave, mbeten të pandryshuara. Ndryshim është vërejtur vetëm në rastin e letrave shtetërore me vlerë trevjeçare, të cilat janë emetuar sërish pas një periudhe më të gjatë, me normë mesatare interesi prej 3,95% (emetimi i fundit në tremujorin e katërt të vitit 2023 me normë mesatare interesi 4,6%). Në segmentin e letrave shtetërore me vlerë pa klauzolë valutore, në tregun primar u emetuan bono thesari dymbëdhjetëmujore, obligacione shtetërore trevjeçare dhe pesëmbëdhjetëvjeçare me norma interesi përkatësisht 3.80%, 3.95% dhe 5.60%.

⁵⁵Strategjia Fiskale 2024-2029, Ministria e Financave, Shtator 2024.

⁵⁶Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, nuk janë emetuar letra shtetërore me vlerë me klauzolë valutore.



Qarkullimi i letrave me vlerë në tregun sekondar në tremujorin e tretë të vitit 2024 ishte 107 milionë denarë, si rezultat i tregtimit të obligacioneve shtetërore me maturim të mbetur prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet (me yield mesatar prej 6,0%). Ndryshime të tilla tregojnë për rritje të lehtë të koeficientit të likuiditetit⁵⁷, në mungesë të tregtimit në tregun sekondar të letrave me vlerë gjatë tremujorit të mëparshëm.




Në tregjet financiare të SHBA-së në tremujorin e tretë të vitit 2024, yield-et e letrave shtetërore me vlerë 10-vjeçare u zvogëluar dhe ishin mesatarisht rreth 4.0% (4.4% në tremujorin e mëparshëm).


⁵⁷Raporti i likuiditetit të tregut sekondar përfaqëson raportin ndërmjet qarkullimit mesatar ditor dhe gjendjes së letrave shtetërore me vlerë.



Lëvizjet e tregut në Eurozonë ishin të ngjashme, ku yield-et e letrave shtetërore me vlerë 10-vjeçare gjithashtu ranë në 2.7% mesatarisht (2.8% në tremujorin e mëparshëm).





Yild-et e euoroboneve maqedonase⁵⁸ në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan zhvendosje të moderuar në rënie mesatarisht, me rënie më të fortë të yield-eve të disa prej obligacioneve shtetërore gjermane. Kjo çoi në zgjerim të lehtë të shumicës së diferencave ndërmjet obligacioneve maqedonase dhe gjermane, të cilat ishin mesatarisht 1.5 p.p., 2.4 p.p., 2.7 p.p. dhe 3,1 p.p., përkatësisht (1,9 p.p., 2,1 pp, 2,4 p.p. dhe 2,8 p.p. në tremujorin e fundit, përkatësisht).





⁵⁸Bëhet fjalë për eurobondet maqedonase të emetuara në janar 2018, qershor 2020, mars 2021 dhe mars 2023. Eurobonot janë emetuar në vlerë nominale përkatësisht 500 milionë euro, 700 milionë euro, 700 milionë euro dhe 500 milionë euro, me afat maturimi përkatësisht 7, 6, 7 dhe 4 vjet dhe norma vjetore interesi 2,75%, 3,675. %, përkatësisht 1.625% dhe 6.96%.

3.3. Bursa

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, vlera e indeksit të bursës maqedonase për aksione MBI-10 u rrit për 13,9% (rritje prej 9% në tremujorin paraardhës) dhe ishte 8779 pikë indeksi. Qarkullimi i përgjithshëm i bursës shënoi rritje tremujore prej 39.7% (pas një rënie prej 0.2% në tremujorin paraardhës), në radhë të parë si rezultat i rritjes së qarkullimit të aksioneve. Vlera e indeksit të obligacioneve (OMB) gjatë tremujorit nuk ka ndryshuar në krahasim me tremujorin paraardhës dhe ishte 123 pikë indeksi.



Në tremujorin e tretë të vitit 2024, indekset e bursave nga rajoni shënuan rritje të ngadaltë tremujore, e cila ishte mesatarisht 2,9% (rritje nga 6,6% në tremujorin e mëparshëm). Në të njëjtën kohë, të gjitha indekset rajonale shënuan rritje, me përjashtim të atij rumun dhe polak, të cilët shënuan një rënie të lehtë. Gjithashtu, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, indekset e luhatshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, përkatësisht indekset MOVE dhe VIX⁵⁹ në baza ditore, ato shënuan rritje, përkatësisht indeksi MOVE u rrit mesatarisht me 4% (pas një rënie prej 7% në tremujorin e mëparshëm), ndërsa indeksi VIX u rrit mesatarisht me 20% (pas një rritje prej 3 % në tremujorin e mëparshëm). Lëvizjet e të dy indekseve⁶⁰, të para së bashku, tregojnë rritje të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë në tregjet globale të kapitalit të lidhura kryesisht me frikën nga recesioni në SHBA, tensionet e rritura gjeopolitike, zgjedhjet parlamentare në Francë dhe rrjedhën e fushatës parazgjedhore SHBA.



⁵⁹Indeksi MOVE (Merrill Lynch Option Volatility Estimate) tregon paqëndrueshmërinë e nënkuptuar të tregjeve amerikane të letrave me vlerë. Indeksi VIX (Volatility Index) është konstruktuar mbi bazën e paqëndrueshmërisë së nënkuptuar të opsioneve të indeksit SIP 500. Investitorët përdorin të dy indekset si tregues të kushteve dhe pritshmërive në lidhje me luhatshmërinë e tregjeve financiare. Rruga në rënie të indekset tregon ulje të paqëndrueshmërisë.


⁶⁰Vlera e indekseve shënoi rritje gjatë tremujorit të tretë, kryesisht si rezultat i frikës nga recesioni në SHBA dhe refuzimit ndaj investimeve në instrumente të rrezikshme, të nxitura nga të dhënat më të dobëta të tregut të punës në ekonominë amerikane të publikuara në fillim të gushtit. Ndikim shtesë në rritje kanë edhe tensionet gjeopolitike në rritje. Lëvizja e indeksit u ndikua edhe nga pasiguria rreth zgjedhjeve parlamentare në Francë në fillim të korrikut, si dhe zgjedhjet presidenciale në SHBA, meqenëse nga mesi i korrikut u rritën pritshmëritë për fitoren e Donald Trump, pasi i mbijetoi atentatit.

IV. Agregate monetare dhe kreditore


Në tremujorin e tretë të vitit 2024, agregati monetar më i gjerë M4 shënoi rritje tremujore më të moderuar. Nga pikëpamja strukturale, rritja vjen më së shumti nga kontributi pozitiv i kursimeve afatgjata dhe në një masë më të vogël edhe të komponentëve më likuidë të M4 (paraja në qarkullim dhe paraja e depozitave), ndërkohë që depozitat afatshkurtra ranë. Tendencat e favorshme të kursimeve në raport me strukturën valutore të afatit të maturimit vijnë edhe në këtë tremujor. Edhe më tej vazhdojnë të dominojnë kursimet afatgjata, si dhe rritja e depozitave në denarë, e inkurajuar nga masat e Bankës Popullore për mbështetjen e denarizimit dhe kursimeve afatgjata. Në tremujorin e tretë vihet re një rritje tremujore e kredive në të dy sektorët, pak më e fortë tek amvisëritë krahasuar me ndërmarrjet. Rezultatet e marra nga Anketa e aktivitetit kreditor (AAK) në tremujorin e tretë të vitit 2024 tregojnë për lehtësim të mëtjeshëm neto të kushteve të përgjithshme të kreditimit dhe rritje neto të kërkesës për kredi, për të dy sektorët, ngjashëm me anketën e tremujorit të mëparshëm.

4.1. Agregate monetare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, oferta më e gjerë monetare M4 shënoi rritje tremujore më të moderuar prej 1.5% (nga 2.8% në tremujorin e dytë). Nga pikëpamja strukturore, rritja tremujore rezulton nga kontributi pozitiv i pothuajse të gjithë përbërësve të ofertës monetare, me përjashtim të depozitave afatshkurtra. Kontributin më të madh pozitiv e shënuan depozitat afatgjata (1.5 pp), më pas paraja e depozituar si komponenti më likuid i ofertës monetare (me kontribut pozitiv prej 0.3 p.p.) dhe paraja në qarkullim (me kontribut pozitiv prej 0.1 p.p.). Depozitat afatshkurtra në këtë tremujor shënuan rënie (me kontribut negativ prej 0.4 p.p.). Për sa i përket **strukturës valutore**, pjesa më e madhe e rritjes tremujore vjen nga depozitat në denarë (me para të depozituara) me kontribut prej 0,8 pp, ndërsa pjesa tjetër nga depozitat në valutë (kontribut pozitiv prej 0,6 pp). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e depozitave në valutë në M4 në fund të tremujorit të tretë mbeti në nivelin e tremujorit paraardhës dhe është 38.3%. Në bazë vjetore, agregati monetar M4 shënoi rritje prej 8.6% (7.6% në fund të tremujorit të dytë).



Depozitat totale në sistemin financiar⁶¹, në tremujorin e tretë të vitit 2024, shënuan rritje më të moderuar prej 1.5% në bazë tremujore (pas rritjes prej 2.7% në tremujorin e dytë). Nga **aspekti sektorial**, depozitat e individëve shënuan kontribut pozitiv prej 1.4 pikë përqindjeje, të ndjekura nga kontributi i depozitave të korporatave prej 0.8 pikë përqindjeje, me kontribut negativ të totalit të depozitave të sektorëve të tjerë prej 0.7 pikë përqindjeje. Nga **aspekti valutor**, depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave) kanë kontribut pak më të lartë, krahasuar me kontributin e depozitave në valutë (përkatesisht 0,9 pp dhe 0,6 p.p.). Për sa i përket **maturimit**, në këtë tremujor vërehet rritje më e ndjeshme në depozitat afatgjata (kontributi pozitiv prej 1.7 p.p.), ndërsa depozitat afatshkurtra kanë pësuar rënie (kontributi negativ prej 0.5 p.p.), gjë që tregon për mbajtjen e lëvizjeve të volitshme në strukturën e maturimit të kursimeve. **Në bazë vjetore**, totali i depozitave në fund të tremujorit të tretë shënoi rritje më të ndjeshme prej 8.4% (7.6% në fund të tremujorit të dytë).



	Depozitat totale											
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshimet tremujore, në %												
Depozitat totale	-2,9	0,2	3,0	4,7	-1,0	4,6	0,7	4,7	-0,6	2,7	1,5	
kontributi në ndryshimet tremujore të totalit të depozitave, në p.p.												
Para të depozituara	-2,8	0,7	1,9	2,5	-1,3	2,5	-0,5	3,9	-1,7	1,7	0,3	
Depozitat në denarë	-1,0	-0,9	0,3	0,7	0,3	1,0	0,4	0,4	0,9	0,7	0,6	
Depozitat në devizë	0,9	0,3	0,9	1,5	0,0	1,0	0,8	0,4	0,2	0,3	0,6	
Depozitat afatshkurte	0,6	0,3	0,7	1,2	-0,2	0,4	0,4	-0,3	-0,1	0,0	-0,5	
Depozitat afatgjate	-0,7	-0,9	0,4	1,0	0,5	1,7	0,8	1,1	1,2	1,0	1,7	
Amvisëritë	-0,9	1,4	1,2	2,0	0,7	1,7	0,0	2,7	1,1	1,8	1,4	
Ndërmarrjet	-2,2	-0,9	1,7	2,5	-1,7	2,5	0,8	2,0	-2,0	0,6	0,8	
Institucionet e tjera	0,2	-0,3	0,1	0,1	-0,1	0,4	-0,1	0,0	0,3	0,3	-0,7	

Burimi: BPRMV.

Edhe depozitat e amvisërive shënuan rritje më të moderuar tremujore në tremujorin e tretë prej 2.1%, krahasuar me rritjen në tremujorin e dytë të vitit (2.7%). Nga **aspekti valutor**, rritja tremujore më së shumti rezulton nga kontributi pozitiv i depozitave në denarë (përfshirë paratë e depozituara), me kontribut më të vogël nga depozitat në valutë (kontribut përkatesisht 1,5 p.p. dhe 0,7 p.p.). Nga këndvështrimi i **strukturës së maturimit**, rritja mbështetet tërësisht nga depozitat afatgjata (me kontribut prej 2.8 p.p.), ndërsa depozitat afatshkurtra ulen (me kontribut negativ prej 1.0 p.p.). Në **bazë vjetore**, rritja e totalit të depozitave të individëve në tremujorin e tretë të vitit 2024 arriti në 11.2% (8.9% në fund të tremujorit të dytë).

Depozitat e ndërmarrjeve në tremujorin e tretë të vitit 2024 janë më të larta për 2,7% në bazë tremujore (rritje prej 2,1% në tremujorin e dytë). Nga këndvështrimi i **strukturës valutore**, rritja kryesisht rrjedh nga depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave), me rritje edhe në depozitat në valutë (me kontribute pozitive përkatesisht 2,5 pp dhe 0,3 pp). Nga **aspekti i maturimit**, depozitat afatshkurtra janë në rritje, ndërsa ato afatgjata janë në rënie. Në **bazë vjetore**, depozitat e ndërmarrjeve në fund të tremujorit të tretë 2024 shënuan rritje prej 4.7% (njëlloj si në fund të tremujorit të dytë).

⁶¹Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetor në banka dhe bankat e kursimeve, aktivet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë pranë BPRMV-së dhe aktivet e njësive të vetëqeverisjes vendore në llogaritë pranë BPRMV-së. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme:

http://www.nbkm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.





Depozitat e amvisërive												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	
ndryshimet tremujore, në %												
Totali i depozitave të amvisërive	-1,4	2,1	1,9	3,1	1,0	2,6	0,0	4,2	1,7	2,7	2,1	
kontributi në ndryshimet tremujore të totalit të depozitave, në p.p.												
Para të depozituara	-1,8	1,1	0,7	2,5	-0,2	1,2	-1,1	3,1	0,0	1,3	0,4	
Depozitat në denarë	-1,4	-0,8	0,0	0,7	0,5	0,9	0,5	0,7	1,2	0,7	1,1	
Depozitat në devizë	1,8	1,8	1,2	-0,1	0,8	0,4	0,6	0,4	0,5	0,8	0,7	
Depozitat afatshkurte	0,9	1,3	0,7	-0,6	0,1	-0,5	-0,2	-0,9	0,2	0,2	-1,0	
Depozitat afatgjate	-0,4	-0,3	0,5	1,2	1,1	1,8	1,3	2,0	1,5	1,3	2,8	

Burimi: BPRMV.

Depozitat e ndërmarrjeve												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	
ndryshimet tremujore, në %												
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	-7,8	-3,2	6,3	9,3	-5,8	9,4	2,8	6,9	-6,7	2,1	2,7	
kontributi në ndryshimet tremujore të totalit të depozitave, në p.p.												
Para të depozituara	-6,0	-0,4	4,7	3,2	-4,5	5,5	0,2	6,0	-6,0	2,1	2,3	
Depozitat në denarë	-0,4	-0,2	1,1	0,5	0,6	1,4	0,8	0,4	0,3	0,3	0,2	
Depozitat në devizë	-1,4	-2,6	0,4	5,7	-1,9	2,5	1,8	0,5	-0,9	-0,3	0,3	
Depozitat afatshkurte	-0,6	-0,8	0,9	5,4	-1,1	2,2	2,2	1,2	-1,8	-1,1	0,6	
Depozitat afatgjate	-1,1	-2,0	0,7	0,7	-0,2	1,7	0,4	-0,3	1,1	1,1	-0,2	

Burimi: BPRMV.

Analiza e yilde-ve⁶² të kursimeve të reja tregon se në gusht normat e interesit të depozitave në denarë dhe në valutë të sapo pranuar⁶³ të **amvisërive** janë 3,3% dhe 2,2%, përkatësisht (3,1% dhe 2,1%, përkatësisht në qershor). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kursimeve të reja në denarë dhe valutë tek amvisëritë në muajin gusht ishte pothuajse e pandryshuar dhe arriti në 1,1 p.p. (1.0 p.p. në tremujorin e dytë). Në sektorin e ndërmarrjeve, normat e interesit për depozitat e reja në denarë dhe në valutë në muajin gusht ishin të njëjta dhe janë në vlerë 2,0%, përkatësisht (2,4% dhe 2,3%, përkatësisht në qershor). Nga pikëpamja e depozitave totale të pranuar (denarë dhe valutë), normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve në fund të muajit gusht janë të pandryshuara në krahasim me qershorin dhe janë në vlerë 2,2%, ndërsa për amvisëritë janë rritur në krahasim me qershorin. me 0.1 p.p. dhe arrijnë në 1.9%.



⁶²Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

⁶³Për sa i përket normave të interesit të depozitave të reja, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Paqëndrueshmëria e normave të interesit për depozitat e sapo pranuar rrjedh nga fakti se ato dalin nga vëllimi i depozitave të reja (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.




4.2. Aktiviteti kreditor

Aktiviteti kreditues i bankave në tremujorin e tretë të vitit shënoi rritje të moderuar tremujore prej 1.5% (ritëm tremujor i rritjes prej 2.9% në tremujorin e dytë). **Anketa e aktivitetit kreditor** e kryer në tremujorin e tretë të vitit 2024 tregon lehtësim-neto të kushteve të miratimit të kredisë. Tek amvisëritë, lehtësimi-neto i kushteve të kredisë është i ngjashëm me anketën e mëparshme, ndërkohë që ka lehtësim-neto pak më të dobët të kushteve të kredisë te ndërmarrjet. Për sa i përket **kërkesës për kredi**, në tremujorin e tretë të vitit vihet re rritje neto më e fortë tek amvisëritë, ndërsa te ndërmarrjet rritja neto e kërkesës është e ngjashme me anketën e mëparshme. Për tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat presin që lehtësimi neto i kushteve të kredisë dhe rritja neto e kërkesës të vazhdojë në të dy sektorët, por më fuqishëm te ndërmarrjet.

Totali i kredive në sektorin privat												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshimet tremujore, në %												
Totali i kredive në sektorin privat	2,6	2,7	1,1	2,6	0,0	2,6	0,5	1,9	1,0	2,9	1,5	
kontributi në ndryshimet tremujore të totalin e kredive, në p.p.												
Kreditë në denarë	1,3	1,1	-0,2	1,2	-0,3	1,3	0,7	1,7	1,1	3,0	1,8	
Kreditë në deviza	1,3	1,6	1,4	1,4	0,4	1,3	-0,3	0,2	-0,1	-0,1	-0,3	
Kreditë afatshkurte	1,4	0,5	-0,1	0,5	-0,5	0,1	-0,5	0,1	0,5	0,0	0,0	
Kreditë afatgjate	1,3	2,0	1,2	2,5	0,6	2,5	1,0	1,8	0,2	2,8	1,4	
Amvisëritë	0,8	1,3	0,8	0,7	0,6	1,1	0,7	0,9	0,7	1,3	1,1	
Ndërmarrjet	1,8	1,3	0,3	1,9	-0,6	1,5	-0,3	1,0	0,3	1,7	0,5	


Burimi: BPRMV.



Analiza e strukturës sektoriale të totalit të kredive të sektorit privat tregon rritje më të moderuar tremujore të kredive si për amvisëritë ashtu edhe për ndërmarrjet (me kontribut përkatësisht 1.1 p.p. dhe 0.5 p.p.). Nga **aspekti valutor**, rritje më e moderuar është shënuar te kreditë në denarë (me kontribut prej 1.8 pikë përqindje), me kontribut negativ të kredive në valutë⁶⁴. Në tremujorin e tretë, analiza nga këndvështrimi i strukturës afatgjate tregon për rritje më të moderuar të kredisë afatgjatë (me kontribut prej 1.4 pikë përqindjeje), ndërkohë që kredia afatshkurtër ka stanjacion, ashtu si në tremujorin e mëparshëm. Pjesëmarrja e **kërkesave të dyshimta dhe të kontestuar**a në totalin e kredive është ende e ulët dhe ka mbetur në nivelin 2.9%.⁶⁵

⁶⁴Të dhënat për kreditë në valutë përfshijnë edhe kreditë në denarë me klauzolë valutore.

⁶⁵Nga fillimi i vitit 2024, në zbatim është Vendimi i ri për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të kredisë të publikuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 57/23, i cili përputhet më tej me kërkesat rregullatore të aplikuara në Bashkimin Evropian dhe forcon stabilitetin e sistemit bankar. Ai parashikon mënyrë të re të përcaktimit të ekspozimeve kreditore jofunksionale, forcon kriteret për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së portofolit të kredisë së bankave dhe përmirëson rregullat për ristrukturimin e ekspozimeve kreditore të bankave. Ndryshimet e reja metodologjike për përcaktimin e kredive jofunksionale mund të sjellin rritjen e tyre, të paktën në periudhën fillestare pas zbatimit të Vendimit, që është më shumë efekt i një qasjeje të ndryshme në përcaktimin e statusit jofunksional (duke numëruar ditë vonesës), sesa e ndryshimit të aftësisë kreditore të klientëve.


**Pjesëmarrja e kredive të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive (në %)**

* I referohet pjesës së pjesëmarrjes së kredive të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive të secilit sektor përkatës.
Burimi: BPRMV.

Në bazë vjetore, totali i kredive në tremujorin e tretë 2024 shënoi rritje prej 7.5% (6.4% në fund të tremujorit të dytë). Në këto kushte, pjesëmarrja e totalit të kredive në totalin e depozitave ka mbetur e pandryshuar në krahasim me tremujorin paraardhës (83.1%).

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, **kreditimi i sektorit "amvisëri"** shënon rritje më të dobët tremujore prej 2.0% (rritje 2.5% në tremujorin e mëparshëm). Në të njëjtën kohë, rritja vijon më së shumti nga kredia konsumatore dhe ajo e banesave, ndërsa kontributi i kredive të tjera është minimal. Rezultatet e Anketës për aktivitetin kreditor për tremujorin e tretë të këtij viti, për sektorin "amvisëri" tregojnë për rritje neto më të fortë të kërkesës totale për kredi, krahasuar me anketën e mëparshme, me lehtësim-neto të kushteve të përgjithshme të kredisë, të ngjashme me tremujorin e fundit. **Nga aspekti valutor**, kontribut më të madh në rritje kanë kreditë në denarë, ndërsa kreditë në valutë kanë një kontribut mesatar pozitiv. E parë nga këndvështrimi i **strukturës së maturitetit**, rritja në tërësi rezulton nga rritja e kredisë afatgjatë, ndërsa stanjacion te kreditë afatshkurtra. **Në baza vjetore**, kreditë totale të amvisërive në fund të tremujorit të tretë 2024 u rritën me 7.7% (rritje prej 7.1% në tremujorin e dytë).

Totali i kredive të amvisërive												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshimet tremujore, në %												
Totali i kredive të amvisërive	1,6	2,6	1,5	1,4	1,2	2,2	1,5	1,7	1,3	2,5	2,0	
kontributi në ndryshimet tremujore të totalin e kredive të amvisërive, në p.p.												
Kreditë në denarë	1,0	1,3	0,5	0,1	0,3	0,8	0,9	0,6	0,7	1,6	1,2	
Kreditë në deviza	0,6	1,3	1,0	1,3	0,8	1,4	0,5	1,1	0,6	0,9	0,9	
Kreditë afatshkurte	0,2	0,1	0,0	-0,2	0,2	0,0	0,3	-0,3	0,2	0,0	0,0	
Kreditë afatgjate	1,3	2,4	1,5	1,9	1,0	2,2	1,2	2,0	0,7	2,2	1,9	
Burimi: BPRMV.												



Në tremujorin e tretë të vitit 2024, shuma e **totalit të kredive të miratuara për sektorin e korporatave** është rritur me 1,0%, në bazë tremujore (nga 3,5% në tremujorin e mëparshëm). Sipas rezultateve të Anketës për aktivitetin kreditor për tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat tregojnë rritje neto të kërkesës për kredi totale nga ndërmarrjet, të ngjashme me anketën e mëparshme, me lehtësim-neto pak më të dobët të kushteve totale të kredisë. Nga **aspekti valutor**, kreditimi në monedhë vendase është në rritje, ndërsa kontributi i kredisë në valutë është negativ. Sipas **strukturës së maturimit**, rritja është nxitur nga kreditë afatgjata, me kontribut të vogël pozitiv të kredive afatshkurtra. **Në bazë**





vjetore, totali i kredive të korporatave në fund të tremujorit të tretë shënoi rritje prej 7.5% (5.8% në fund të tremujorit paraardhës).

Kredi të ndërmarrjeve											
	2022				20Kv				2024		
	Kv.1	Kv.2	Kv.3	Kv.4	Kv.1	Kv.2	Kv.3	Kv.4	Kv.1	Kv.2	Kv.3
ndryshime tremujore , në %											
Totali i kredive të ndërmarrjes	3,7	2,8	0,7	3,9	-1,3	3,1	-0,6	2,1	0,7	3,5	1,0
kontribut në ndryshimin tremujor në totalin e kredive, në p.p.											
Kredi në denarë	1,7	0,9	-1,0	2,4	-1,1	2,0	0,5	2,9	1,5	4,6	2,6
Kredi në valutë	2,0	1,8	1,8	1,5	-0,2	1,1	-1,1	-0,7	-0,8	-1,1	-1,6
Kredi afatshkurtra	2,7	0,9	-0,3	1,3	-1,4	0,3	-1,3	0,6	0,8	-0,1	0,2
Kredi afatgjata	1,3	1,5	1,0	3,1	0,2	2,6	0,7	1,6	-0,3	3,5	1,0

Burimi: BPRMV

Sipas të dhënave për normat e interesit⁶⁶ të kredive të reja të miratuara⁶⁷ në gusht, normat e interesit për kreditë në denarë dhe në valutë për amvisëritë janë përkatësisht 6,4% dhe 3,8% (6,1% dhe 3,9%, përkatësisht në qershor). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe në valutë të amvisërive u rrit në 2,5 p.p. (2.2 p.p. në tremujorin e dytë). Te ndërmarrjet, normat e interesit për kreditë e sapoaprovuara në denarë dhe në valutë janë 4,9% dhe 4,6% përkatësisht (5,0% dhe 4,9%, përkatësisht në qershor), pra diferenca e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe në valutë të ndërmarrjeve u rrit dhe arriti në 0.3 p.p.. Për sa i përket **totalit të kredive** të miratuara për sektorin privat, në fund të muajit gusht normat e interesit për kreditë për amvisëritë dhe ndërmarrjet ishin përkatësisht 5.7% dhe 5.2%, që paraqet rënie minimale te ndërmarrjet me 0.1 p.p. dhe është i pandryshuar te amvisëritë, krahasuar me qershorin e vitit 2024.




⁶⁶Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

⁶⁷Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e sapo miratuara rrjedh nga fakti se ato rezultojnë nga vëllimi i kredive të sapo miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

V. Financat publike

Në tremujorin e dytë të vitit 2024 është vërejtur rritje e lartë vjetore e të ardhurave buxhetore (prej 15%) dhe rënie vjetore e shpenzimeve buxhetore (prej 1.3%), e cila ka ndikuar në uljen e deficitit buxhetor në bazë vjetore, e cila u reduktua në 1,0% të PBB-së (2,4% e PBB-së në të njëjtin tremujor të një viti më parë). Në periudhën janar-gusht 2024, deficitin buxhetor është 2.6% e PBB-së, përkatësisht 52.9% e deficitit të planifikuar për vitin 2024 sipas rebalancit të buxhetit. Deficiti buxhetor i realizuar në periudhën janar-gusht 2024 është financuar më së shumti nëpërmjet huamarrjes neto të shtetit në tregun e brendshëm dhe në një masë të vogël në tregun e jashtëm, me akumulim të vogël të depozitave të shtetit në Bankën Popullore. Borxhi publik total në fund të tremujorit të dytë 2024 është 61.2% e PBB-së dhe është relativisht i qëndrueshëm në bazë vjetore.


Në tremujorin e dytë të vitit 2024, të ardhurat totale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁶⁸ shënuan përsheptim të rritjes që arriti në 15% në bazë vjetore (5.2% në tremujorin e mëparshëm). Për këtë rritje vjetore kontribuuan pothuajse të gjitha kategoritë e të ardhurave buxhetore me përjashtim të të ardhurave të tjera⁶⁹ të cilat shënojnë rënie vjetore. Në kornizat e kategorive të veçanta, pjesëmarrje më të madhe në ritmin e rritjes së të ardhurave totale e kanë tatimet, me kontribut prej 10.2 pp. (5,9 p.p. në tremujorin paraardhës), si dhe të ardhurat nga kontributet me kontribut prej 4,8 p.p., si edhe në tremujorin paraardhës.




Rritja vjetore e **totalit të të ardhurave tatimore** në tremujorin e dytë të 2024 u përsheptua dhe arriti në 17.8%. Të tilla arritje vijnë nga kontributi më i lartë i të ardhurave nga tatimet indirekte, kryesisht nga të ardhurat nga TVSH-ja (me kontribut prej 9.8 p.p.), por në një masë më të vogël nga akciza dhe taksat e importit (kontributet përkatësisht 0.1 p.p. dhe 0.9 p.p.). Gjithashtu, tatimet direkte kanë kontribut pozitiv në ritmin e rritjes së të ardhurave tatimore, përkatësisht tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin (me kontribute përkatësisht 2.7 p.p. dhe 3.2 p.p.).

⁶⁸Buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve.

⁶⁹Të ardhurat e tjera përfshijnë të ardhurat nga kapitali, donacionet e huaja dhe të ardhurat nga hua të arkëtuara.




Burimi: Ministria e Financave




Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV-së

Shpenzimet totale buxhetore të realizuara në tremujorin e dytë 2024 shënuan një rënie të lehtë në bazë vjetore, prej 1.3%. Nga pikëpamja strukturore, rënia në totalin e shpenzimeve vjen si pasojë e uljes së shpenzimeve kapitale⁷⁰, gjatë rritjes së shpenzimeve vijuese. Rritja vjetore e shpenzimeve vijuese rrjedh kryesisht nga kategoria „transferet“⁷¹ (kontribut nga 8,8 p.p.), dhe rritja në kategoritë "paga dhe kompensime", "pagesat e interesit", dhe "mallra dhe shërbime" ka kontribut më të moderuar (përkatësisht nga 2.7 p.p., 1.4 p.p. dhe 1.0 p.p.,).



Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV-së



Burimi: Ministria e Financave

Deficiti buxhetor në tremujorin e dytë të vitit 2024 arriti në 9,186 milionë denarë, ose 1,0% e PBB-së.⁷² që paraqet realizim më të ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (deficit prej 2.4% të PBB-së). Deficiti i realizuar në tremujorin e dytë është financuar kryesisht nëpërmjet huamarrjes neto të shtetit në tregun e brendshëm dhe në masë më të vogël në tregun e jashtëm⁷³, gjatë tërheqjes së mjeteve nga depozitat e shtetit në Bankën Popullore.

⁷⁰Shpenzimet kapitale janë më të ulëta për shkak të bazës më të lartë krahasuese nga tremujori i dytë i vitit 2023, kur një shumë më e konsiderueshme është paguar për financimin e projektit të ndërtimit të infrastrukturës rrugore (korridoret 8 dhe 10d).

⁷¹Kategoria "transferet" i referohet shpenzimeve të pensioneve, shpenzimeve të mbrojtjes sociale, shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe transfertave të tjera (kryesisht subvencione).

⁷²Në suazatë analizës, janë përdorur projeksionet e tetorit të Bankës Popullore për PBB-në nominale për vitin 2024.

⁷³Në muajin maj, shteti ka marrë 50 milionë euro hyrje nga huaja nga Komisioni Europian.



BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (Buxheti qendror dhe buxheti i fondeve)

	2023					2024					2024					
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Total 2023	Total 2024	Rebalanci i Buxhetit 2024	Tr.1	Tr.2	jan. - gusht. 2024	Tr.1		Tr.2		jan. - gusht. 2024	
											Ndryshime vjetore, në %	Kontribut në ndryshim vjetor, në p.p.	Ndryshime vjetore, në %	Kontribut në ndryshim vjetor, në p.p.	Ndryshime vjetore, në %	Kontribut në ndryshim vjetor, në p.p.
TË ARDHURA TOTALE	66.009	65.140	66.326	79.652	277.127	310.128	318.150	69.332	74.882	197.543	5,0	5,0	15,0	15,0	12,4	12,4
Të ardhura dhe kontribute tatimore	56.651	60.485	60.232	72.987	250.355	279.044	284.469	63.587	70.280	184.016	12,2	10,5	16,2	15,0	16,3	14,7
Tatime*	35.896	37.352	37.403	47.082	157.733	178.067	179.257	39.761	43.996	115.790	10,8	5,9	17,8	10,2	16,5	9,3
Kontribute	20.755	23.133	22.829	25.905	92.622	100.977	105.212	23.911	26.284	68.226	15,2	4,8	13,6	4,8	15,9	5,3
Të ardhura jotatimore	3.905	3.785	4.456	4.719	16.865	20.394	22.541	4.957	3.848	11.237	26,9	1,6	1,7	0,1	6,7	0,4
Të ardhura kapitale	193	180	1.026	672	2.071	3.210	3.240	199	148	597	3,1	0,0	-17,8	0,0	-6,6	0,0
Donacione të huaja	5.260	690	612	1.274	7.836	7.479	7.900	590	606	1.693	-88,8	-7,1	-12,2	-0,1	-73,2	-2,6
SHPENZIME TOTALE	69.533	85.199	70.326	93.516	318.574	343.638	362.816	84.085	84.068	221.153	20,9	20,9	-1,3	-1,3	9,0	9,0
Shpenzime vijuese	64.209	68.606	64.526	77.709	275.050	298.459	318.118	77.077	78.152	204.776	20,0	18,5	13,9	11,2	16,0	13,9
Shpenzime kapitale	5.324	16.593	5.800	15.807	43.524	45.179	44.698	7.008	5.916	16.377	31,6	2,4	-64,3	-12,5	-37,7	-4,9
DEFICITI BUXHETOR / SUFICITI	-3.524	-20.059	-4.000	-13.864	-41.447	-33.510	-44.666	-14.667	-9.186	-23.610						
Financimi	3.524	20.059	4.000	13.864	41.447	33.510	44.666	14.667	9.186	23.610						
Hyrje	9.569	21.876	35.309	18.281	85.035	78.564	83.727	33.128	14.210	51.256						
Hyrje të tjera	287	344	230	414	1.275	0	500	253	43	642						
Huamarrje jashtë vendit	31.142	529	176	30.008	61.855	43.164	48.487	9.939	3.530	13.591						
Depozita	-35.047	16.141	25.056	-20.401	-14.251	-4.863	-20.388	-2.135	3.223	-388						
Bono thesari	13.187	4.862	9.847	8.260	36.156	40.263	55.128	25.071	7.414	37.410						
Shitja e aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0						
Të dala	6.045	1.817	31.309	4.417	43.588	45.054	39.061	18.461	5.024	27.646						
Pagesa e kryegjësë	6.045	1.817	31.309	4.417	43.588	45.054	39.061	18.461	5.024	27.646						
Bonchi i huaj	1.065	1.381	30.304	3.364	36.114	26.429	20.334	6.610	3.402	11.834						
Bonchi vendas	4.980	436	1.005	1.053	7.474	18.625	18.727	11.851	1.622	15.812						
Të dala të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0						

* Përfshin të ardhura tatimore (SPP)

Burimi: Ministria e financave dhe përlogaritje të BPRMV-së


Në periudhën janar - gusht 2024, të ardhurat totale buxhetore janë më të larta me 12.4% në bazë vjetore. Kjo më së shumti rezulton nga ecuria më e mirë e të ardhurave tatimore dhe kontributeve, dhe në masë më të vogël nga të ardhurat jotatimore, përderisa për shkak të bazës më të lartë krahasuese vitin e kaluar, të ardhurat nga donacionet e huaja⁷⁴shënojnë rënie të thellë. Në të njëjtën kohë, shpenzimet buxhetore janë më të larta për 9% në bazë vjetore, gjë për të cilën kontribuojnë plotësisht shpenzimet vijuese, me shpenzime kapitale më të ulëta. Në periudhën janar-gusht 2024, deficitin buxhetor arrin në 23.610 milionë denarë ose 2,6% të PBB-së, që paraqet 52,9% të deficitit të planifikuar për vitin me ribalancimin e buxhetit⁷⁵për vitin 2024. Deficiti i realizuar është financiar në pjesën më të madhe nëpërmjet huamarrjes neto në tregun e brendshëm dhe në një masë më të vogël në tregun e jashtëm⁷⁶, me grumbullim të vogël të depozitave të shtetit në Bankën Kombëtare.

⁷⁴Në mars 2023, donacionet e huaja u rritën për shkak të grantit të marrë nga Bashkimi Europian në shumën 72 milionë euro për përballimin e krizës energjetike.

⁷⁵Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 169 data 15.8.2024.

⁷⁶Hyrje e kështit të dytë prej 155 milionë eurosh nga programi PLL (Linja e kujdesit dhe likuiditetit) të Fondit Monetar Ndërkombëtar në janar dhe hyrje prej 50 milionë eurosh nga kredi nga Komisioni Europian në maj. Në muajin mars, shteti pagoi kësht prej rreth 70 milionë eurosh për obligacionin e njohur si "Namensschuldverschreibungen", përkatësisht NSV.

Borxhi publik në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

Gjendja e totalit të borxhit publik⁷⁷ në fund të tremujorit të dytë 2024, është 61.2% e PBB-së, që paraqet një rritje prej 0.7 p.p. të PBB-së krahasuar me fundin e tremujorit të mëparshëm. Kjo në masë të madhe vjen si pasojë e rritjes së borxhit të brendshëm, ndërkohë që borxhi i jashtëm është rritur më pak⁷⁸. Nga këndvështrimi i strukturës së borxhit, rritja ka ardhur tërësisht nga borxhi total shtetëror⁷⁹ i cili është rritur 0,7 p.p. dhe është 52,8% e PBB-së, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të paguarantura)⁸⁰ mbeti në të njëjtin nivel si në tremujorin e mëparshëm (8.5% e PBB-së). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, borxhi publik total në fund të tremujorit të dytë 2024 është më i lartë me 0.2 pikë përqindjeje nga PBB-ja.

VI. Projektionet makroekonomike dhe rreziqet

Pamja makroekonomike për periudhën 2024-2026 nuk ka ndryshuar ndjeshëm krahasuar me projektionet e prillit. Në lidhje me rritjen ekonomike, edhe më tej pritet përshpejtim gradual i aktivitetit ekonomik, me rritje si rezultat i kërkesës së brendshme, me kontribut negativ të eksporteve neto. Megjithatë, në afat të shkurtër, dinamika e rritjes është ngadalësuar pak në krahasim me projektionin e mëparshëm, gjë që është kryesisht reflektim i realizimit më të dobët në gjysmën e parë të vitit 2024, e cila, së bashku me rikuperimin pak më të dobët të kërkesës së huaj, pritet të ndikojë edhe mbi rritjen vitin e

⁷⁷Borxhi publik përcaktohet me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19) sipas të cilit ai përfaqëson shumën e borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose kryesisht në pronësi të shtetit ose komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

⁷⁸Në mars u pagua kësti i parë i obligacionit ("Namensschuldverschreibungen" - NSV) në vlerën rreth 73 milionë euro, i cili u emetua në vitin 2022, në tregun gjerman, në vlerën 250 milionë euro me maturim 3 vjet dhe 18 muaj grejs periudhë, me normë interesi EURIBOR 6-mujor plus marzh prej 3.75%. Ndërsa në muajin janar është marrë hyrje e këstit të dytë prej 155 milionë euro nga programi PLL (Linja e kujdesit dhe likuiditetit), dhe në maj është marrë kësti i parë në vlerën rreth 50 milionë euro, nga huaja në shumë totale prej 100 milionë euro miratuar nga Komisioni Europian.

⁷⁹Borxhi kombëtar përkufizohet si shuma e borxheve të qeverisë qendrore, fondeve publike dhe komunave.

⁸⁰Në përputhje me ndryshimet në Ligjin për Borxhin Publik nga maji i vitit 2019, borxhi i paguarantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/ 05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19).

ardhshëm.⁸¹ Kështu, rritja e parashikuar ekonomike në vitin 2024 do të arrijë në 2.3% (2.6% në prill) dhe më pas do të përshpejtohet në 3.3% në vitin 2025 (3.6% në prill) dhe 4% në periudhën afatmesme 2026-2027 (e pandryshuar në raport me parashikimet e prillit). Kjo dinamikë bazohet në pritshmëritë për mjedis të jashtëm më të mirë, kombinuar me disa faktorë specifikë të brendshëm, veçanërisht të lidhur me ciklin e infrastrukturës publike. Të ardhurat e disponueshme, si një komponent kyç i të ardhurave të popullsisë, pritet ende të rriten dhe, së bashku me kreditimin, të mbështesin konsumin e popullsisë. **Nga aspekti i inflacionit, ai do të vazhdojë të ruajë rrugën e rregullimit rënës deri në fund të periudhës së projeksionit. Vlerësohet se në vitin 2024 norma mesatare e inflacionit do të jetë 3.5%, e njëjtë si në projeksionet e prillit dhe 2.5% në vitin 2025, që është një rishikim i lehtë në rritje në krahasim me prillin, duke pasur parasysh inercinë e pranishme në disa kategori çmimesh. Në periudhën afatmesme, në periudhën 2026 - 2027, inflacioni pritet të ulet në mesataren historike prej 2%, ashtu si edhe në projeksionet e prillit. Pritjet për pozicionin e jashtëm të ekonomisë janë të përafërta me ato të parashikuara më parë dhe tregojnë për vazhdimësi të pozicionit të qëndrueshëm dhe të favorshëm të llogarisë vijuese në periudhën afatmesme. Stabilizimi i bilancit në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe normalizimi i transfertave private, pas prurjeve të konsiderueshme në vitin 2023 pritet të çojë në deficit të llogarisë vijuese prej 2.1% të PBB-së në vitin 2024, pak më i moderuar se në prill. Në periudhën afatmesme, deficitin e llogarisë vijuese do të jetë mesatarisht 2.2% e PBB-së. Gjatë gjithë periudhës së projeksionit priten flukse hyrëse të qëndrueshme neto në llogarinë financiare, të mbështetura nga investimet direkte dhe huamarrja e shtetit, me të cilat rezervat valutore do të vazhdojnë të rriten dhe të mbeten në nivelet e duhura.**

6.1 Supozimet në projeksionin e mjedisit të jashtëm⁸²

Vlerësimet më të reja për **kërkesën e huaj efektive**⁸³ edhe më tej vazhdojnë të tregojnë rikuperimin e saj gradual, ndërkohë që pritet që rritja në vitin 2024 të arrijë në 0,8% (njëlloj si në prill), ndërsa për vitin 2025 pritet përshpejtim dhe normë rritjeje prej 1.5% (1.6% në prill). Rishikimi minimal në rënie në vitin 2025 është për shkak të perspektivës së rritjes më të dobët në ekonominë gjermane⁸⁴. Për vitin 2026, pritet që rritja e kërkesës së huaj të përshpejtohet më tej dhe të arrijë në 1,7%.


⁸¹Në datën 30.09.2024, ESHS ka publikuar të dhënat përfundimtare të PBB-së për vitin 2022 dhe më 18.10.2024 të dhënat e mëparshme për vitin 2023, sipas të cilave ka rishikim në rritje të ritmeve reale të rritjes në këto dy vite në raport me të dhënat e fundit tremujore të publikuara nga data 04.09.2024. Megjithatë, kjo e dhënë e rishikuar nuk përdoret në projeksionet e PBB-së, pasi përmban vetëm të dhëna të PBB-së për vitin, por jo shpërndarje sipas tremujoreve, e cila është rrezik për vetë projeksionet, për shkak të bazës më të lartë.

⁸²Si burim i të dhënave historike për kërkesën e huaj, inflacionin e huaj, kursin e këmbimit dollar/euro dhe për EURIBOR-in përdoret Eurostat, ndërsa për çmimet e naftës, ushqimeve dhe metaleve përdoret statistika e Bankës Botërore. Projeksionet e kërkesës së huaj, inflacionit të huaj, kursit të këmbimit të dollarit amerikan dhe EURIBOR-it bazohen në "Konsensus forkast", ndërsa projeksionet për çmimet e naftës, ushqimeve dhe metaleve janë bazuar në parashikimet e analistëve të tregut. Në analizë janë përdorur raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, BQE-së, FAO-s, OPEK-ut dhe portaleve të specializuara ekonomike.

⁸³Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e ponderuar e indekseve të prodhimit bruto produktit vendor real të partnerëve më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e eksporteve. Në përlllogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria.

⁸⁴Norma reale e rritjes ekonomike të Gjermanisë parashikohet në 0% në vitin 2024 dhe rritje prej 1.0% dhe 1.3% në vitin 2025 dhe 2026, krahasuar me rritjen prej 0.1% në vitin 2024 dhe 1.2% në vitin 2025, përkatësisht në prill.

Nga ana tjetër, te **inflacioni efektiv i huaj**⁸⁵ është bërë një rishikim minimal në rënie i vlerësimit për këtë vit, me vlerësim të pandryshuar për vitin e ardhshëm. Kështu, në vitin 2024 pritet inflacion prej 3.2% (3.5% në prill) dhe ulje e mëtejshme e presioneve të çmimeve në vitin 2025 dhe 2026, gjë që do të ulte rritjen e çmimeve në këto vite në përkatësisht me 2.5% dhe 2.3%. Për më tepër, korrëgjimi në rënie për vitin 2024 është kryesisht rezultat i korrëgjimeve rënese të inflacionit në Itali, Slloveni dhe Bullgari.



Për sa i përket **kursit të këmbimit euro/dollar amerikan**, pritet zhvlerësim minimal pak më i lartë i dollarit amerikan për vitin 2024 (0.7%, në vend të 0.6% të parashikuar në prill), që lidhet me uljen më të fortë të normave të interesit nga FED në krahasim me me BQE-në në shtator⁸⁶. Nga ana tjetër, për vitin 2025 pritet rënie më e vogël e vlerës së dollarit amerikan kundrejt euros, krahasuar me parashikimet e mëparshme, pra zhvlerësim prej 1.4%, (zhvlerësim prej 2.7% në prill) dhe zhvlerësim pritët edhe në vitin 2026 prej 1.7%.

Çmimi i naftës i shprehur në euro⁸⁷ është korrëgjuar në rënie për 2024 dhe 2025 kështu që tani pritët rënie e çmimeve me 3.4% dhe 10.2% në vitin 2024 dhe 2025, përkatësisht (rënie me 0.7% dhe 8.7% në vitin 2024 dhe 2025, përkatësisht në prill). Rënia e çmimit të naftës vjen si pasojë e uljes së projeksioneve për kërkesën në të ardhmen, kryesisht si rezultat i aktivitetit më të dobët ekonomik në Kinë, si dhe rritjes së refuzimit ndaj rrezikut nga subjektet e tregut⁸⁸ dhe zvogëlimit të rreziqeve për ofertën⁸⁹. Në vitin 2026 pritët rënie e mëtejshme por më e ngadalshme (prej 3.4%).



⁸⁵Inflacioni i jashtëm efektiv llogaritet si shumë e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve që janë partnerët më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të mallrave të konsumit. Në përlllogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë Bullgaria, Gjermania, Greqia, Spanja, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Polonia, Kroacia dhe Serbia. Inflacioni në Poloni dhe Serbi është përshtatur me ndryshimet e kursit të këmbimit.

⁸⁶Më 18 shtator 2024, FED uli normën bazë të interesit me 0.5 p.p., kështu që diferenca e normës së interesit tani arrin në 4.75% - 5% (5.25% - 5.5% më parë), ndërsa BQE-ja në shtator uli normën e interesit për depozitat e disponueshme me 0.25 p.p. (nga 3.5% në 3.25%).

⁸⁷Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore primare, përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO-s, OPEK-ut, BQE-së dhe portaleve të specializuara ekonomike ndërkombëtare.



⁸⁸Burimi: Buletini i BQE-së, nr.6,2024 (lidhja internet: <https://www.ecb.europa.eu/press/economic-bulletin/html/eb202406.en.html>).

⁸⁹Frika nga ndërprerjet e mundshme të furnizimit për shkak të përshkallëzimit të konfliktit në Lindjen e Mesme u lehtësua në mes të tetorit, me njoftimet se Izraeli nuk do të sulmonte rafineritë e naftës të Iranit (lidhjet në internet: <https://www.ft.com/content/30a8a233-1c72-4d95-8e5e-55f7ae92e7bc> и <https://www.ft.com/content/720bb920-a546-4f5a-b77e-5328419037bf>).




Për sa u përket çmimeve të metaleve, rishikimet janë në drejtim të ndryshëm në periudhën 2024-2025. Konkretisht, sipas vlerësimeve të fundit, për vitin 2024 pritet rënie pak më e madhe e çmimit të nikelit dhe stabilizim i tij në vitin 2025 (përkundër rritjes në muajin prill), në kushtet e një oferte më të madhe në nivel global. Nga ana tjetër, për sa i përket çmimit të bakrit, në vitin 2024 pritet rritje më e lartë e tij në krahasim me muajin prill, edhe më tej, por më i vogël (përkundër nivelit të pandryshuar në parashikimet e prillit), si pasojë e pritjeve për kërkesë më të madhe për bakër nga Kina. Çmimet e çelikut pritet të bien shumë më ndjeshëm në vitin 2024 krahasuar me parashikimet e prillit, por tani pritet rritje në vitin 2025, në krahasim me një rënie të vogël në prill. Në vitin 2026, çmimet e nikelit pritet të rriten, ndërsa për çmimet e bakrit dhe çelikut pritet rënie e lehtë.

Për sa u përket **çmimeve të produkteve ushqimore**, në periudhën 2024-2025 është bërë rishikim në rënie krahasuar me muajin prill. Kështu, për vitin 2024 pritet rënie më e madhe e çmimeve për misrin dhe grurin dhe për vitin 2025 rritje më e dobët krahasuar me parashikimet e prillit. Rishikimi në rënie i çmimeve të grurit dhe misrit është për shkak të vlerësimeve të ofertës më të lartë në nivel global. Në vitin 2026 pritet rritje e lehtë e mëtejshme e çmimeve të grurit dhe misrit.



Për sa i përket **normës së interesit të EURIBOR-it njëmuor**, është kryer rishikim i vogël në rritje i vlerësimeve për vitet 2024 dhe 2025. Kështu, momentalisht vlerësohet se norma mesatare e EURIBOR-it njëmuor në vitin 2024 do të jetë 3.60% (3.36% në prill), 2.55% në vitin 2025 (2.50% në prill), ndërsa në vitin 2026 pritet të ulet në 2.25%. Lëvizje të tilla janë në përputhje me pritshmëritë për ulje graduale të normave të interesit të BQE-së, por pak më të ngadalësuara për shkak të mbajtjes së inflacionit bazë në nivel më të lartë se sa pritej.





6.2 Projektioni dhe efekte mbi politikën monetare

Mjedisi për zhvillimin e politikës monetare karakterizohet ende nga pasiguri dhe është nën ndikimin e dinamikës së ardhshme të inflacionit. Projektionet e fundit për inflacionin tregojnë ende për një ngadalësim të tij dhe ulje të mesatares historike në periudhën afatmesme, por gjithsesi me dinamikë më të ngadaltë se prilli, për shkak të inercisë më të madhe të inflacionit bazë. Në të njëjtën kohë, rreziqet mbeten të konsiderueshme dhe lidhen me tensionet gjeopolitike dhe efektin e tyre në çmimet e produkteve parësore, por edhe me sjelljen e politikave të brendshme që ndikojnë mbi kërkesën në ekonomi. Nga aspekti i **normës së interesit të huaj**, si përcaktues i rëndësishëm i politikës monetare të brendshme, ulja graduale e normave të interesit të BQE-së pritet të vazhdojë edhe më tej, por me ritëm pak më të ngadaltë se në muajin prill, për shkak të relaksimit më të moderuar nga sa pritej në projektionet e prillit. **Me këtë cikël projektionesh, pozicioni i jashtëm i ekonomisë së brendshme vlerësohet sërish si i volitshëm**, me pothuajse të njëjtat pritshmëri për llogarinë vijuese, mesatarisht për periudhën 2024-2026 si në projektionin e prillit. Lëvizje të tilla në transaksionet vijuese, me flukse solide të parashikuara njëkohësisht në llogarinë financiare, rezultojnë **me rritjen e rezervave valutore në bazë agregate dhe mbajtjen e tyre në një nivel që korrespondon me standardet ndërkombëtare për ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit**.

Rreziqet kryesore për skenarin bazë makroekonomik janë të ngjashme me ato të muajit prill. Përsa i përket mjedisit të jashtëm, rreziqet si në afat të shkurtër ashtu edhe në atë afatmesëm janë ende të pavolitshme dhe veçanërisht të theksuara. Trazirat gjeopolitike, të lidhura kryesisht me përshkallëzimin e mëtejshëm të mundshëm të konflikteve rajonale (Lindja e Mesme dhe Ukraina), zgjatja e politikës së shtrënguar monetare ose përparimi më i ngadalshëm i normalizimit që ka filluar, rigjallërimi i mundshëm i paqëndrueshmërisë së tregut financiar me efekte negative në tregjet për financimin e borxheve të qeverisë, ngadalësim më i madh i rritjes së ekonomisë kineze sesa pritej dhe forcimi i vazhdueshëm i politikave proteksioniste janë faktorë kyç për kufizimin e rritjes globale. Për sa i përket rreziqeve nga mjedisi i brendshëm, në afat të shkurtër ato lidhen me dinamikën e realizimit të projekteve të infrastrukturës, ndërsa si rreziqe pozitive në afat të mesëm, përsëri vlerësohen efektet nga anëtarësimi në NATO, nga ecuria në negociatat për anëtarësim në BE, nga Plani i ri i rritjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor i BE-së, që mund të kontribuojnë në përshpejtimin e reformave strukturore.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, ekonomia e brendshme shënoi rritje të moderuar prej 1.8% dhe ishte rezultat i kontributit pozitiv të faktorëve të brendshëm, me vëllim më të madh të investimeve bruto. Rritja pritet të përshpejtohet në gjysmën e dytë të vitit, në përputhje me pritjet për vazhdimin e prirjeve të favorshme në komponentët e kërkesës së brendshme, të plotësuar me pritje më të favorshme për eksportet në përputhje me rikuperimin gradual të kërkesës së huaj. Aktiviteti më i lartë

i eksportit i kombinuar me përshpejtimin e kërkesës së brendshme pritet të kontribuojë në rritjen e komponentit të importeve në pjesën e dytë të vitit. Rrjedhimisht, **rritja në vitin 2024 do të ishte 2.3%** dhe do të nxitej kryesisht nga faktorët e kërkesës së brendshme, kryesisht nga investimet bruto, ndërkohë që eksportet neto edhe më tej do të kenë kontribut negativ. **Në periudhën e ardhshme pritet përshpejtim i mëtejshëm i rritjes, i cili do të arrijë në 3.3% në vitin 2025 dhe 4% në periudhën afatmesme, në periudhën 2026 - 2027.** Nga këndvështrimi i strukturës së rritjes në dy vitet e ardhshme nuk pritet asnjë ndryshim, pra do të rezultojë nga kërkesa e brendshme, me kontribut negativ nga eksportet neto.



Në suazat e kërkesës së brendshme, pritet kontribut pozitiv nga të tre komponentët, por investimet bruto dhe konsumi personal vlerësohen të jenë nxitësit kryesorë të rritjes në periudhën 2024 - 2026. Pas rënies së fortë në vitin 2023, në vitin 2024 pritet rritje e ndjeshme e **investimeve bruto** sipas arritjeve të favorshme në gjysmën e parë të vitit, dhe pritshmërive për aktivitet më të madh investues deri në fund të vitit. Në dy vitet e ardhshme parashikohet që investimet bruto të vazhdojnë të shënojnë ritme solide rritjeje, në përputhje me pritshmëritë për realizimin e investimeve publike në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, veçanërisht në pjesën e ndërtimit të korridoreve 8 dhe 10-d. Gjithashtu, ndikim pozitiv në periudhë afatmesme pritet edhe nga investimet private, të nxitura mbi të gjitha nga nevoja për qëndrueshmëri energjetike dhe investime në burimet e rinovueshme të energjisë, rritja e investimeve të huaja direkte, rikuperimi i eksporteve dhe kërkesa e huaj efektive, si dhe mbështetje solide kreditore nga sektori bankar.


Konsumi i amvisërive pritet të rritet në vitin 2024, ngjashëm me atë të një viti më parë. Konkretisht, pas arritjeve modeste në gjysmën e parë të vitit, pavarësisht rritjes solide të të ardhurave reale të disponueshme, pritet përshpejtim në pjesën e dytë të vitit, mbështetur nga rritja e masës reale të pagave dhe masat për rritjen e pensione⁹⁰. Për më tepër, vlerësimi i rritjes së pagave në vitin 2024 përfshin edhe realizimin⁹¹, si dhe efektin e rritjes së pagave në sektorin publik⁹², ndërsa rritja e pensioneve është përshtatur sipas ndryshimeve ligjore për rritje lineare të pensioneve dhe rritje

⁹⁰Më 12 shtator 2024 u votuan ndryshimet dhe plotësimet ligjore në Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, me të cilin parashikohet rritje e pensioneve më 1 shtator 2024 dhe 1 mars 2025 për 2.500 denarë.

⁹¹Në suazat e zbatimit përfshihet edhe efekti i **rritjes së pagës minimale** në përputhje me ndryshimet ligjore me pagesën e pagës së marsit, dhe efekti i transferuar i rritjes së pagave në sektorin publik në shtator të vitit 2023.

⁹²Përfshihet rritje pagash në sektorin publik, duke filluar nga **shtatori i vitit 2024**, në përputhje me **MPK**-në, e cila parashikon se nëse diferenca ndërmjet indeksit të shpenzimeve së jetesës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, krahasuar me indeksin e shpenzimeve së jetesës për gjashtëmujorin e parë të muajt në vitin 2023 kalon 3%, paga bazë bruto e punonjësve të sektorit publik rritet në përqindje për diferencën deri në 3%. Njëkohësisht, në tetor të vitit 2024 është parashikuar rritje shtesë e pagave në **arsim për 5%**, sipas marrëveshjes së Qeverisë me SASHK-un.

të moderuar të numrit të pensionistëve. Për dy vitet e ardhshme pritet rritje mesatarisht më e fortë e konsumit personal, e cila do të rezultojë kryesisht nga dinamika e të ardhurave të disponueshme, brenda së cilës masa e pagave dhe pensione janë nxitësit kryesorë të rritjes, në përputhje me rritjen e ekonomisë, pajtueshmëritë ligjore⁹³ dhe rritjen e moderuar të numrit të të punësuarve dhe pensionistëve. Gjithashtu, në dy vitet e ardhshme pritet mbështetje financiare shtesë për konsumin e popullsisë nëpërmjet kanalit tradicional të financimit, që është kreditimi nga bankat.



Në përputhje me planet fiskale⁹⁴, pritet rritje e konsumit publik gjatë gjithë periudhës së projeksionit, ku e njëjta do të kishte kontribut pozitiv në rritjen e pritshme të PBB-së.

Pas realizimit të dobët të **eksportit të mallrave dhe shërbimeve** në gjysmën e parë të vitit 2024, si reflektim mbi të gjitha i faktorëve specifikë të përkohshëm⁹⁵, por edhe me kërkesën e huaj ende të dobët, në gjysmën e dytë të vitit pritet rikuperim gradual i aktivitetit eksportues, i cili nuk do të kompensojë rënien e realizuar më parë. Për rrjedhojë, për të gjithë vitin 2024, eksportet pritet të shënojnë rënie të lehtë. Në dy vitet e ardhshme, tejkalimi i faktorëve kufizues të përkohshëm, rikuperimi gradual i kërkesës së huaj efektive dhe situata e volitshme e çmimeve në çmimet e metaleve do të ndikojë pozitivisht në sektorin tradicional të eksporteve. Në të njëjtën kohë, kontribut pozitiv pritet të japin kompanitë tashmë ekzistuese nga industria automobilistike, si dhe investimet e reja të huaja në sektorin e prodhimit. Rrjedhimisht, rruga e parashikuar tregon rritje solide të eksportit të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2025 dhe ngadalësim të moderuar të tij në vitin 2026.

⁹³Për periudhën **2025-2026**, rritja e pagave të administratës publike dhe zyrtarëve përshtatet me rritjen vjetore të **pagës mesatare** të vitit paraprak. Për periudhën nga shtatori i vitit 2025, pensionet janë përshtatur sipas metodologjisë së mëparshme me të cilën llogaritet rregullimi i pensionit të pleqërisë sipas ndryshimit të indeksit të shpenzimeve të jetesës në masën 50% dhe ndryshimit të pagës mesatare të paguar për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në shumë prej 50 %. Në rastet kur nuk ka rritje lineare të pensioneve, pensioni rregullohet më 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti sipas përqindjes së përfutur si shumë e rritjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës në gjashtëmujorin e mëparshëm dhe përqindjes së rritjes së pagës mesatare të paguar për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjashtëmujorin e kaluar, në raport me gjashtëmujorin paraardhës.

⁹⁴Projeksionet e shpenzimeve publike bazohen në të dhënat nga Rebalanci i Buxhetit për vitin 2024 nga gushti i vitit 2024 dhe Strategjia Fiskale e Rishikuar 2025 - 2029 nga shtatori i vitit 2024.

⁹⁵Bëhet fjalë për mosfunksionimin e kapaciteteve të konsiderueshme nga industria e metaleve dhe automobilistike, të cilat pritet të tejkalohen pjesërisht në fund të këtij viti dhe plotësisht vitin e ardhshëm.



Importet reale të mallrave dhe shërbimeve pritet të kenë rritje minimale në vitin 2024, të nxitura kryesisht nga komponentët e kërkesës së brendshme. Në dy vitet e ardhshme pritet që rritja e kërkesës së brendshme dhe e aktivitetit eksportues të kontribuojnë në rritjen edhe të komponentit të importit. Duke marrë parasysh rritjen e parashikuar më të fortë të importeve sesa të eksporteve, eksportet neto pritet të kenë kontribut negativ në rritjen e PBB-së gjatë gjithë periudhës së projektimit.

Në kushtet e procesit të nisur të lehtësimit të moderuar të politikës monetare, pritet që dinamika e rritjes së **aktivitetit kreditor** të vazhdojë edhe në gjysmën e dytë të vitit, ku deri në fund të vitit 2024 rritja do të arrijë në 7.5% në bazë vjetore (rritje prej 5,1% në fund të vitit 2023). Në periudhën afatmesme pritet stabilizim i ritmeve të rritjes së kredisë, të cilat do të arrinin mesatarisht 7.2% për periudhën 2025-2027. Projektione të tilla janë në përputhje me pritshmëritë për ulje të mëtejshme graduale të normave të interesit, përshpejtim të rritjes ekonomike, stabilizim të pritjeve dhe besim gjithnjë e në rritje të subjekteve ekonomike. Për sa u përket **depozitave**, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues, priten edhe ritme solide rritjeje gjatë gjithë periudhës së projektionit, në kushtet e rritjes së besimit në monedhën vendase, si dhe për shkak të rritjes së pritshme të të ardhurave monetare të popullsisë. Kështu, në vitin 2024 pritet që rritja e totalit të depozitave të arrijë në 7.9% (9.1% në fund të vitit 2023), ndërsa në periudhën 2025 - 2027 parashikohet rritje mesatare prej 7.7%.

Pas ecuresë së mirë të bilancit të transaksioneve vijuese në vitin 2023 dhe suficitit të realizuar në bazë neto, projektioni aktual parashikon përkeqësim të caktuar të llogarisë vijuese, gjegjësisht pritet deficit i moderuar prej 2.1% të PBB-së për vitin 2024. Kjo dinamikë vjen si pasojë e suficitit më të ulët të të ardhurave dytësore, më konkretisht të hyrjeve neto të transfertave private, të cilat pas nivelit më të lartë historik në vitin 2023 pritet të stabilizohen. Gjithashtu, deficitin tregtar pritet të zgjerohet në baza vjetore, i nxitur nga komponenti joenergjetik, me reduktim të mëtejshëm të parashikuar të deficitit të bilancit të energjisë. Përkundrejt kësaj, ecuria pozitive në shërbime pritet të vazhdojë edhe në vitin aktual, me çka suficiti në këtë kategori do të ndiqte një rrugë në rritje, duke zbutur pothuajse tërësisht rritjen e deficitit tregtar. **Në vitin 2025 pritet përkeqësim i lehtë i llogarisë vijuese prej 0.2 p.p., me çka deficitin i llogarisë vijuese do të arrinte në 2.3% të PBB-së.** Reduktimi gradual i pjesëmarrjes së transfertave private në PBB, pavarësisht stabilizimit të tyre nominal, pritet të jetë faktori nxitës për një dinamikë të tillë të llogarisë vijuese. Gjithashtu, intensifikimi i pritshëm i aktiviteteve të ndërtimit në lidhje me korridoret 8 dhe 10-d do të ndikonte negativisht në bilancin e shërbimeve, i cili pritet të ulë suficitin në këtë kategori në baza vjetore. Nga ana tjetër, dinamika e favorshme e çmimeve të energjisë parashikohet të çojë në ngushtim të mëtejshëm të deficitit energjetik, ndërkohë që rikuperimi i aktivitetit eksportues të sektorit të përpunimit të metaleve dhe forcimi i efektit neto pozitiv të kapaciteteve të huaja në industrinë automobilistike do të ndikojnë ndjeshëm në ngushtimin e komponentit joenergjetik dhe rrjedhimisht të deficitit tregtar total. **Në periudhën afatmesme, 2026-2027, deficitin i llogarisë vijuese pritet të stabilizohet në nivel mesatar prej 2.2% të PBB-së,** gjatë uljes së vazhdueshme të deficitit në bilancin e mallrave dhe shërbimeve. **Për sa u përket hyrjeve financiare neto, në periudhën 2024 - 2027, ato pritet të financojnë plotësisht deficitin e llogarisë vijuese, duke mundur rritje shtesë të rezervave valutore.** Nga pikëpamja strukturore, pjesa më e madhe e hyrjeve financiare mbi bazën neto priten në formën e investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes afatgjatë të shtetit. **Është veçanërisht e**




rëndësishme të theksohet se gjatë gjithë periudhës së projeksionit pritet që rezervat valutore të mbahen në nivelin e duhur.

Projeksioni i Bilancit të pagesave (në % i PBB-së)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Llogaria rrjedhëse	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	0.4	-2.1	-2.3	-2.2
Saldo e mall. dhe shër.	-12.7	-14.3	-12.7	-15.5	-21.0	-13.9	-14.1	-13.7	-12.7
Mallra, neto	-16.2	-17.3	-16.6	-19.7	-26.7	-19.3	-21.6	-20.3	-19.5
Shërbime, neto	3.5	3.0	3.9	4.2	5.7	5.4	7.5	6.5	6.8
Të ardhura primare, neto	-4.2	-4.6	-3.8	-4.4	-4.4	-5.4	-5.2	-5.1	-5.4
Të ardhura dytësore, neto	17.1	16.0	13.6	17.1	19.2	19.7	17.2	16.5	16.0
Sektori privat, neto	16.1	15.6	12.6	16.0	18.7	18.8	16.8	16.0	15.5
Llogaria kapitale	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Llogaria financiare	-4.5	-5.6	-3.9	-4.8	-7.9	-3.7	-2.8	-1.6	-3.4
IHD, neto	-5.6	-3.2	-1.4	-3.3	-5.0	-3.6	-4.2	-3.7	-4.0
Portofolio e investimeve, neto	-3.0	1.3	-2.6	-1.0	-0.4	0.2	1.6	4.0	0.3
Investime të tjera, neto	4.1	-3.7	0.1	-0.5	-2.5	-0.4	-0.1	-1.8	0.4

Burimi: BPRMV

Norma e inflacionit në vitin 2024 do të ngadalësohet dhe do të ishte mesatarisht 3.5%, (9.4% në 2023). Rënia e theksuar e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore bazuar në tregun ndërkombëtar, rritja është e ngadaltë dhe inflacioni i jashtëm efektiv, si dhe efektet e politikave shtrënguese monetare kontribuojnë në lëvizjen rënëse të çmimeve të brendshme. Komponentët e ushqimit dhe energjisë shënojnë ngadalësim më të fortë, dhe në rastin e inflacionit bazë, për shkak të inercisë më të madhe rregullimet janë më graduale. **Ngadalësimi i inflacionit pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim dhe vlerësohet se rritja mesatare vjetore e çmimeve do të ulet në 2.5% në vitin 2025 dhe 2% në periudhën 2026-2027.** Rruga në rënie e çmimeve pritet për të tre komponentët në vitin 2025⁹⁶, ndërsa nga aspekti i strukturës vlerësohet se kontributin më të madh në inflacionin total do ta ketë inflacioni bazë. Stabilizimi gradual i inflacionit në periudhën afatmesme pritet të vijë si rezultat i shterimit të efekteve të goditjeve të jashtme të çmimeve, ankorimit të mëtejshëm të pritjeve inflacioniste dhe mungesës së presioneve të rëndësishme nëpërmjet kanalit të kërkesës së brendshme dhe hendekut të prodhimit. Megjithatë, rreziqet për projeksionin e inflacionit janë në rritje dhe në raport me mjedisin e jashtëm lidhen me çmimet e produkteve parësore, të cilat ndikohen nga konteksti i paqëndrueshëm gjeopolitik dhe faktorët klimatikë. Për sa u përket faktorëve të brendshëm, rreziqet vijnë nga presionet e mundshme të çmimeve për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët e vegjël në tregun e rregulluar nga korriku i vitit 2024, si dhe për amvisëritë në periudhën në vijim, rritja e pagave dhe pensione dhe konsolidimi fiskal më i ngadalshëm sipas strategjisë më të fundit fiskale.



⁹⁶Përsa i përket komponentit ushqimor, vlerësohet se aplikimi i [Ligjit për Ndalimin e Praktikave të Padrejta Tregtare](#) do të ndikojë në mënyrë të volitshme mbi çmimet e ushqimeve.

6.3 Krahasimi me projeksionin e mëparshëm

Në projeksionet e fundit, pamja makroekonomike nga këndvështrimi i rrugës së rritjes ekonomike dhe ngadalësimit të inflacionit për të gjithë periudhën e projeksionit nuk ka ndryshuar ndjeshëm në krahasim me ciklin e prillit. Për sa i përket intensitetit të ndryshimeve, janë bërë korrigjime të vogla në rënie të pritjeve për rritjen ekonomike në vitet 2024 dhe 2025 dhe një korrigjim i vogël në rritje të normës së inflacionit për vitin 2025. Ndryshimi i rritjes së aktivitetit ekonomik në vitin 2024 vjen kryesisht si pasojë e arritjeve më të ulëta në gjysmën e parë të vitit, të cilat, së bashku me vlerësimet për rikuperim pak më të ngadaltë të kërkesës së huaj, kërkuar rishikim të lehtë në rënie të projeksionit për rritje në vitin 2025. Për sa i përket inflacionit, për vitin 2024 pritjet që norma e parashikuar të realizohet në përputhje me ciklin e prillit, por me presione më të mëdha mbi çmimet e ushqimeve dhe më të ulëta mbi çmimet e energjisë, ndërkohë që perceptimet për inflacionin bazë janë të pandryshuara. Inflacioni në vitin 2025 do të ngadalësohet, por pak më i ngadalshëm në krahasim me pritjet e prillit, për shkak të inercisë më të madhe në inflacionin bazë dhe efektit të bartjes nga viti i kaluar. Pozicioni i jashtëm i parashikuar në periudhën 2024-2026 në nivel agregat është afër projeksionit të prillit, me llogari vijuese pak më të mirë në vitin 2024 dhe pritshmëri pak më të këqija për dy vitet e ardhshme. Nga këndvështrimi i komponentëve individualë, mesatarisht, pritshmëritë më të mira për bilancin e mallrave dhe shërbimeve janë kompensuar nga parashikime disi më pak të favorshme për suficitin e të ardhurave dytësore, si rezultat i ndryshimit të pritjeve për transfertat private. Për sa u përket hyrjeve neto të parashikuara në llogarinë financiare, projeksionet aktuale parashikojnë flukse hyrëse pak më të ulëta në bazë neto në krahasim me muajin prill, me reflektim të caktuar në rritjen e pritshme të rezervave valutore, të cilat janë ende të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të monedhës vendase.



Projeksiioni i variablave të selektuara makroekonomike

	2024 projeksion		2025 projeksion		2026 projeksion
	prill	tetor	prill	tetor	tetor
PBB %	2.6	2.3	3.6	3.3	4.0
Konsumi personal	4.0	2.4	2.6	2.7	2.6
Investime bruto	10.5	11.2	7.0	7.0	6.5
Konsumi publik	-6.5	2.7	-1.0	5.2	3.9
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	3.6	-1.3	5.6	7.7	2.1
Importi i mallrave dhe shërbimeve	5.6	0.8	4.6	8.6	2.3
Inflacioni	3.5	3.5	2.0	2.5	2.0
Deficiti i llogarisë rrjedhëse , ,% i PBB-së	-2.4	-2.1	-2.1	-2.3	-2.2


Burimi: BPRMV

Në kushtet e rritjes paksa më të ngadaltë të ekonomisë vendase në gjysmën e parë të vitit 2024 krahasuar me pritjet e prillit, **u bë korrigjim i vogël në rënie të rritjes për vitin 2024, shoqëruar me ndryshime të caktuara në raport me kontributin e komponentëve të veçantë.** Konkretisht, rritja e lartë e pagave dhe rrjedhimisht e të ardhurave të disponueshme të familjeve në gjysmën e parë të vitit 2024 nuk është reflektuar në rritjen e konsumit privat sipas pritshmërive dhe aktiviteti i eksportit dhe rrjedhimisht i importit ka pasur arritje më të dobëta. Nga ana tjetër, konsumi publik pati impuls pozitiv në aktivitetin ekonomik, në kundërshtim me pritjet për rënie reale dhe investimet bruto shënuan rritje më të lartë se sa pritej, veçanërisht në tremujorin e parë. Lëvizje të tilla u reflektuan në projeksionin e rritjes ekonomike për vitin 2024, pra ndikuan në rishikimin në rënie të kontributit të kërkesës së brendshme në rritje, për shkak të rregullimit të konsumit personal. Rritja më e dobët e pritshme për vitin 2024, së bashku me vlerësimet për rikuperim pak më të ngadaltë të kërkesës së huaj, **kushtëzuan gjithashtu rishikim të lehtë në rënie të projeksionit të rritjes në vitin 2025, duke mbajtur të njëjtën strukturë rritjeje.** Kështu, pritjet sërisht kontribut pozitiv nga kërkesa e brendshme, por më i lartë se në muajin prill. Konkretisht, për vitin 2025 parashikohet rritje më e lartë dhe kontribut më i fortë i konsumit privat në rritje, në përputhje me pritjet për rritje të mëtejshme të pagave reale të larta, rritje

më të fortë të pensioneve në krahasim me pritjet e prillit për shkak të rritjes lineare të planifikuar në mars të vitit të ardhshëm dhe efektit të transfertave nga rritja në shtator të këtij viti, si dhe nga perceptimet për rritje pak më të fortë të kredive për amvisëritë. Konsumi publik pritjet të regjistrojë rritje, kundrejt pritjeve për rënie sipas parashikimeve të prillit, në kushtet e konsolidimit fiskal më të ngadaltë se sa pritej në prill. Nuk ka ndryshime në rritjen e investimeve bruto, ndërkohë që pritjet sërish kontribut i fuqishëm nga sektori publik, në përputhje me pritshmëritë për realizimin e projekteve të planifikuara të infrastrukturës publike, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, si dhe ndikim pozitiv nga sektori privat në lidhje me qëndrueshmërinë e energjisë dhe rritjen e IHD-ve. Eksportet neto pritjet të kenë kontribut më të madh negativ në rritjen ekonomike, me rritje më të fortë si në aktivitetin e eksporteve ashtu edhe të importeve krahasuar me parashikimet e prillit. Rritja më e fortë e eksporteve, në kushtet e kërkesës së jashtme minimalisht më të ulët krahasuar me pritjet e muajit prill, rezulton nga ulja e bazës krahasuese në vitin 2024, ndërsa tek importet nga impulsi më i fortë nga kërkesa e brendshme dhe nga baza e ulët krahasuese.



Për sa i përket projeksionit të normës së inflacionit, ai ende pritjet të jetë në rënie deri në fund të periudhës së projeksionit. Kështu, për vitin 2024, inflacioni parashikohet të jetë 3.5%, aq sa parashikohej edhe në suazat e ciklit të projeksioneve të prillit. Për sa u përket komponentëve individualë, është bërë korrigjim në rritje i çmimeve të ushqimeve, në përputhje me realizimet më të larta në raport me projeksionin. Nga ana tjetër, në komponentin energjetik, rishikimet janë në drejtim rënës, duke reflektuar më së shumti arritje më të ulëta, kryesisht si pasojë e rritjes më të ulët të çmimit të energjisë elektrike nga sa ishte supozuar në muajin prill, dhe pjesërisht si pasojë e korrigjimit në rënie të vlerësimeve për çmimin botëror të naftës, ndërsa në rastin e inflacionit bazë, vlerësimet janë të pandryshuara. Për vitin 2025 pritjet inflacion prej 2.5%, i cili përfaqëson korrigjim të vogël në rritje në raport me pritjet e muajit prill për rritjen e çmimeve prej rreth 2%, që i detyrohet pjesërisht efektit më të lartë të transfertave nga viti i kaluar, me vlerësime për inerci më të madhe në komponentë të caktuar të çmimeve. **Për vitin 2026 nuk janë bërë ndryshime, pra ende pritjet të ulët norma e inflacionit në nivelin historik prej 2.0%.**



Projeksionet aktuale nuk parashikojnë ndryshime të rëndësishme për lëvizjet e ardhshme të llogarisë vijuese, ndonëse ka lëvizje të caktuara në drejtim të dinamikës. Konkretisht, në vitin 2024 parashikohet deficit pak më i ulët i transaksioneve vijuese krahasuar me ciklin e prillit, me 0.3 p.p. të PBB-së (nga 2.4% në 2.1% të PBB-së), kryesisht si rezultat i suficitit më të lartë të pritshëm në shërbime, si dhe pritshmërie pak më të mira për bilancin tregtar, të mbështetur tërësisht nga komponenti energjetik. Nga ana tjetër, projeksioni aktual parashikon flukse hyrëse neto pak më të ulëta në të ardhurat dytësore krahasuar me muajin prill. **Për periudhën 2025-2026, projeksioni i tetorit parashikon deficit minimal mesatar më të lartë të llogarisë vijuese krahasuar me ciklin e mëparshëm të projeksioneve të prillit, i cili është rishikuar nga 2.1% e PBB-së në 2.2% të PBB-së, që kryesisht ka të bëjë me pjesëmarrjen e ulët të të ardhurave dytësore në PBB, me pritshmëri më të favorshme për bilancin tregtar në këto dy vite. Për sa u përket flukseve financiare, të analizuara në bazë agregate, për periudhën 2024 – 2026 priten flukse neto pak më të ulëta krahasuar me ato të parashikuara në muajin prill. Për sa u përket investimeve të huaja direkte, projeksioni vijues parashikon flukse hyrëse neto pak më të larta gjatë periudhës së projeksionit, ku kjo kategori mbetet një burim veçanërisht i rëndësishëm financimi i deficitit të llogarisë vijuese.**

Krahasimi i projeksioneve për PBB-në dhe inflacionin në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Organizata	Muaji i publikimit	Rritja reale e PBB-së %			Inflacioni (mesatarja %)		
		2024	2025	2026	2024	2025	2026
FMN	tetor 2024	2,2	3,6	3,8	3,3	2,3	2,0
Banka Botërore	tetor 2024	1,8	2,5	3,0	3,5	2,8	2,0
Komisioni European	maj 2024	2,9	3,0	-	3,0	1,9	-
EBOR	shtator 2024	2,2	3,5	-	-	-	-
Konsensus Forkast	tetor 2024	2,1	3,0	-	3,5	2,7	-
Ministria e Financave	shtator 2024	2,1	3,7	4,0	3,5	2,2	2,0
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	tetor 2024	2,3	3,3	4,0	3,5	2,5	2,0

Burimi: MMF, Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2024; Banka Botërore, Raport i rregullt për Ballkanin Perëndimor, vjeshtë 2024; Komisioni European, Projeksione për ekonominë europiane, pranverë 2024; EBOR, Perspektiva rajonale ekonomike shtator 2024; Konsensus Forkast, tetor 2024; Ministria e Financave, Strategjia fiskale për vitin 2025-2029, shtator 2024; dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

